



BANKA PËR BIZNES

BpB



2014 RAPORTI
VJETOR

Që nga fillimi...
Është pjesë e sukseseve tona...
Është dëshmitare e momenteve të lumtura...
Kontribuon në realizimin e ëndrrave tona...
Është gjithmonë aty...
Sepse ajo është...

BANKA E VENDIT TËND

2014 RAPORTI
VJETOR

Përmbajtja

- 06 Misioni dhe Visioni
- 08 Struktura Organizative
- 10 Letra e kryetarit
- 12 Letra e kryeshefit ekzekutiv
- 14 BpB në shifra
- 16 Pasqyra makroekonomike e vitit 2014
- 18 Zhvillimet financiare
- 23 Biznesi me klientë
- 27 Rrjeti i degëve
- 29 Teknologjia informative
- 32 Operacionet
- 34 Pagesat kombëtare dhe ndërkombëtare
- 35 Biznesi dokumentar
- 36 Thesari
- 39 Administrimi i kredive
- 42 Menaxhimi i rrezikut kreditor
- 43 Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit
- 45 Menaxhimi i rrezikut të valutës dhe normës së interesit
- 46 Menaxhimi i rrezikut operacional
- 50 Strategjia e burimeve njerëzore
- 52 Përgjegjësia sociale e korporatës
- 57 Raporti i audituesve të pavarur dhe pasqyrat financiare
 - 58 Raporti i Audituesve të Pavarur
 - 59 Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Përmbledhëse
 - 60 Pasqyra e Pozicionit Financiar
 - 61 Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
 - 62 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
- 63-100 Shënime lidhur me Pasqyrat Financiare



A photograph of three young people sitting outdoors. A woman on the left is taking a selfie with her smartphone. A woman in the middle is looking towards the camera with a slight smile. A man on the right is smiling. The background shows a building with a window. The image has a warm, orange-toned overlay.

Misioni


Të jemi partner i besueshëm i klientëve në plotësimin e kërkesave financiare dhe mbështetës i sigurt në zhvillimin e gjithëmbarshëm të tyre.


Vizioni

Vizioni i Bankës për Biznes është që të rritet në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim të mbështetjes së individëve dhe bizneseve në zhvillimin e tyre ekonomik.



Struktura Organizative





Letra e kryetarit

Viti 2014 ishte sfidues për 'Banka për Biznes' (më tutje 'Banka') në disa fusha.

Kosova nuk ka qenë imune nga rënia ekonomike dhe problemet me të cilën janë përballur ekonomitë Evropiane dhe botërore.

Ekonomia Kosovare është përballur me zvogëlim të qarkullimit të parasë, e cila ka bërë presion tek bizneset dhe aftësitë e tyre për të financuar huazimet e tyre, dhe ka rezultuar që bankat të ushtrojnë më shumë kujdes në marrjen e vendimeve me risk kreditor.

Richard Beasley është emëruar Kryeshef Ekzekutiv i bankës, në mars të vitit 2014. Ai trashëgoi një bankë që kishte performancë të ulët në shumicën e treguesve dhe ka kaluar shumicën e vitit duke u siguruar që disa nga kreditë që për një kohë të gjatë ishin jo-performuese të provizionohen siç duhet. Menaxhmenti i lartë është përqendruar në mbulimin e kredive joperformuese dhe në uljen e shpenzimeve duke ngrirë pagat, mbyllur degët joprofitabile, rinegocimin e qirave dhe vendosjen e çmimeve të reja për produkte dhe shërbime.

Aksionarët kanë respektuar rregulloren e Bankës Qendrore mbi zgjedhjen e anëtarëve të rinj. Tre nga ata janë tërhequr në muajin prill. Fatkeqësisht, që nga ajo kohë, identifikimi i individëve të kualifikuar për të zënë këto pozita të lira në Bord, ka rezultuar sfidues dhe ndonëse Bordi ka vijuar të takohet, ky nuk ka pasur kuorum dhe ka qenë pa një kryesues të emëruar.

Kam kënaqësinë të raportoje se anëtari i pestë i Bordit është miratuar nga Banka Qendrore, në shkurt të vitit 2015 dhe Bordi më ka përzgjedhur mua si Kryetar.

Tani banka po përqendrohet në klientë privatë si dhe në biznese të vogla dhe të mesme. Portfolio kreditore është rritur ndjeshëm dhe është më pak e varur nga një numër i vogël i klientëve të mëdhenj. Kjo duhet të sigurojë që në të ardhmen banka është më pak e ekspozuar ndaj risqeve të mëdha.

Si rezultat i masave të cekura më lartë, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), banka ka gjeneruar 1.5 milion euro neto profit pas tatimit. Performanca e mirë e bankës është për t'u mirëpritur dhe tani Banka është në pozitë të mirë për të hyrë në vitin 2015, me një pasqyrë më të fortë të bilancit si dhe shumë nga masat e vendosura për të përmirësuar edhe më tej performancën tonë.

Stafi i është përgjigjur pozitivisht ndryshimeve, disa prej të cilave kanë paraqitur vështirësi, por stafi është informuar vazhdimisht përgjatë secilës fazë, dhe përmes Këshillit Menaxhues të krijuar rishtazi, ata janë përfshirë në të gjitha vendimet e marrura.

Në emër të bordit dëshiroj të falënderoj si menaxhmentin ashtu edhe stafin, për besnikërinë e tyre dhe fokusin që këto ndryshime të mund të ndodhin.

Unë besoj se banka gjendet në pozitë të mirë për tu zhvilluar më tutje në vitin 2015 dhe do të kem kënaqësinë që vitin tjetër të mund të raportoj rezultate edhe më të mira tek aksionarët.

Oliver Whittle

Kryetar i bordit



Letra e kryeshefit ekzekutiv

Gjatë vitit 2014, bankat në Kosovë kanë vijuar të fokusohen në kreditë tek sektori i biznesit, ku ka dominuar sektori i tregtisë, ndërkohë që sektori i prodhimit dhe ai i ndërtimtarisë ka shënuar rënie. Aktiviteti prodhues mbetet stagnues dhe në shumicën e zonave të vendit çmimet e pronave dhe të qirasë kanë mbetur të pandryshuara ose kanë shënuar rënie.

Megjithatë, ka pasur rritje në huadhënie tek sektori i bujqësisë dhe për të përmbushur këtë kërkesë banka ka dedikuar këshilltarë për marrëdhënie me klientët nëpër gjithë rrjetin e degëve të saj që punojnë posaçërisht për të përmbushur nevojat e klientëve të përfshirë në prodhimin dhe përpunimin e ushqimit.

Viti në shqyrtim ka qenë vit i ndryshimeve të rëndësishme për bankën. Gjatë tremujorit të parë, banka ka mbyllur, përafërsisht, 30 për qind të rrjetit të vet të degëve. Megjithatë, degët e cekura kanë qenë kryesisht në lokacione të largëta dhe kryesisht kanë ofruar shërbime pagesash. Numri i vogël i klientëve që janë ndikuar nga kjo, ose janë drejtuar në degët më të afërta, ose kanë kaluar në mundësitë e ofruara nga banka për pagesa elektronike.

Gjatë riorganizimit, shumica nga stafi janë zhvendosur në vende të tjera përgjatë rrjetit. Banka ka vijuar me politikën e vet për përmirësimin e aftësive të menaxhimit të riskut.

Gjatë vitit 2014, proceset e administrimit dhe miratimit të kredive janë zhvendosur gradualisht në zyrën qendrore. Ky ripozicionim ka pasur përfitimin e dyfishtë të zvogëlimit të riskut operacional dhe të lirim të stafit të degëve nga detyrat administrative, ashtu që të kenë mundësi të kalojnë më shumë kohë, që të merren me nevojat e klientëve.

Pas rënjes në vitin 2013, portfolio kreditore e bankës u rrit në vitin 2014. Depozitat e besuara bankës kanë shënuar gjithashtu rritje, duke arritur nivelin prej 103 milionë euro në fund të vitit. Megjithëse portfolio kreditore është në rritje, shkalla e kredive joperformuese në fund të vitit ishte në nivelin 8.3 për qind, e cila është brenda mesatares së tregut vendor. Ky rezultat është arritur përmes një mjedisi të menaxhimit kujdesshëm të riskut kreditor, që thekson vlerësimin e vlerës kreditore dhe analizën.

Bordi i bankës ka vendosur disa objektiva financiare për vitin 2014, duke përfshirë një objektiv për fitimin neto. Kam kënaqësinë të raportoje se objektivi për fitimin neto është tejkaluar dhe rezultati paraqet kthim në kapitalin mesatar prej 16.9 për qind për vitin 2014, një përmirësim i rëndësishëm në rezultatet e viteve të fundit.

Dëshiroj ta përmbyll, duke falënderuar të gjitha ata që kanë ndihmuar që viti 2014, të jetë vit i suksesshëm: kolegët e mi për punën dhe përkushtimin e vazhdueshëm, anëtarët e Bordit për drejtimin dhe mirëkuptimin e tyre dhe aksionarët për përkushtimin dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

Në fund, falënderimet e mia shkojnë për të gjithë klientët tanë për besimin dhe besnikërinë e tyre që vazhdojnë të tregojnë ndaj bankës.

Richard Beasley

Kryeshf ekzekutiv

Richard Beasley



BpB në shifra

*në mijëra, aty ku aplikohet

● 31 Dhjetor 2013

● 31 Dhjetor 2014





Pasqyra makroekonomike e vitit 2014

Gjatë vitit 2014, ndonëse jo në nivelin e pritur ose dëshiruar, aktiviteti global ekonomik ka shfaqur përmirësime marginale. Në anën tjetër, ka pasur dallime të qarta ndërmjet rajoneve. Përderisa disa ekonomi botërore u përmirësuan me ritme më të shpejta, ka pasur rajone që vetëm sa e kanë shmangur recesionin.

Eurozona, përkundër uljes së vazhdueshme të normës së interesit nga Banka Qendrore Evropiane, ka dëshmuar ulje të kërkesës dhe të normës së inflacionit, e cila si rezultat ka ngritur shqetësimet për një deflacion të mundshëm. Ballkani ka parë rritje ekonomike të vazhduar. Ekonomia e rajonit është rritur me 1.8 për qind, që është një dallim i rëndësishëm nga viti i kaluar (2013), kur kishte përmirësim prej 2.5 për qind. Karakteristika e ndarë në vendet e Ballkanit mbetet deficit i lartë aktual, i cili më 2014 u rrit edhe më tej. Në ekonominë botërore, vendet në Ballkan janë ende vende importuese dhe ka nevojë për shumë përmirësime në prodhim për të shtuar eksportet, në mënyrë që të ulët deficitin tanishëm.

Politikat fiskale që kanë për synim përmirësimin e bilancit të buxhetit qeveritar në vendet e Ballkanit, kanë treguar rezultate pozitive, por borxhi publik mbetet i lartë. Sektori bankar në Ballkan ishte karakterizuar nga rritja e kursimeve dhe rezultate mikse në huadhënie. Përderisa pothuajse të gjitha shtetet kanë raportuar rritje të depozitave, në disa shtete të Ballkanit huadhëniet kanë shënuar ulje, kurse në disa shtete të tjera kanë shënuar rritje të lehtë.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, vendi ka shënuar një nga rritjet më të larta në rajon, duke rezultuar në rritje të BPV-së (GDP-së) prej 3 për qind. Rritja ekonomike i është atribuar rritjes së konsumit, ndërkohë që mungesa e investimeve dhe e eksporteve neto janë arsye pse ekonomia nuk ka përmirësime në shkallë më të lartë sesa ajo e arritur. Rritja e konsumit ishte si rrjedhojë e remitencave të rritura dhe rritjes së numrit të shtuar të kredive konsumuese, të huazuara nga popullata. Viti 2014, gjithashtu ka shënuar rritje të eksporteve, por për shkak të importit shumë të lartë, neto eksportet ende mbajnë ekonominë në nivele të ulëta.



Zhvillimet financiare



Indikatorët financiar

Banka, gjatë vitit 2014, i kishte neto të hyrat nga interesi rreth 6.5 milion euro. Kjo kategori e të hyrave përfaqëson rreth 75 për qind të hyrave operative totale të bankës, dhe krahasuar me vitin paraprak, pati një rritje për afër 1.4 milion euro ose 27 për qind.

Shpenzimet e interesit për vitin 2014, ishin rreth 2.5 milion euro (2013: 4.0 milion euro). Neto të hyrat nga tarifatat dhe komisionet arritën nivelin prej 1.6 milion euro gjatë vitit 2014, duke shënuar një rritje për mbi 14 për qind, krahasuar me vitin 2013. Edhe pse të hyrat bruto nga tarifatat dhe komisionet u rritën për 21 për qind, ishin shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që po ashtu u rritën për afër 60 për qind, e të cilat shkaktuan një ulje në rritjen e neto të hyrave nga tarifatat dhe komisionet.

Provizionet për kredi dhe mjete të tjera gjatë vitit 2014, u rriten për afër 0.5 milion euro, duke shënuar nivelin neto prej 2.3 milion euro (2013: 1.8 milion euro). Nga kjo rritje, shumica (0.4 milion euro) ishte provizion i ndarë për kredi, përderisa pjesa tjetër e rritjes rreth 0.1 milion euro, është provizion i ndarë për mjete tjera.

Viti 2014 u veçua sa i përket kursimit në shpenzimet operacionale të bankës, ku krahasuar me vitin paraprak, shpenzimet operacionale ishin më të vogla për 0.2 milion euro, që përfaqësojnë një rënie prej 4.8 për qind krahasuar me vitin 2013. Raporti i kostove operacionale mbi të hyrat operacionale ishte 58 për qind, nga 77 për qind sa ishte në vitin 2013.

Banka gjatë vitit 2014, arriti një profit neto prej 1.5 milion euro, duke rritur kështu kapitalin nga 8.2 milion euro, sa ishte në vitin 2013, në 9.7 milion euro në vitin 2014. Indikatorit i kthimit në kapitalin mesatar arriti nivelin prej 16.9 për qind, nga 0.3 për qind sa ishte vitin e kaluar.

Edhe gjatë vitit 2014, Banka vazhdoi të rris stabilitetin e fondeve duke u fokusuar në depozita më stabile dhe me afatgjata, si dhe në diversifikimin e strukturës së tyre, duke kaluar prej depozitave me vlera më të mëdha nga institucionet e ndryshme, tek depozitat me vlera më të vogla nga personat fizikë dhe bizneset e vogla, të cilat konsiderohen si më të qëndrueshme dhe më stabile.







Biznesi me klientë

Biznesi me klientë

Biznesi me klientë gjatë vitit 2014, ka pas një rritje në krahasim me vitin paraprak, respektivisht në portofolion kreditore, ka pas një rritje prej 10 për qind.

Ndarja e klientëve në tri segmente kryesore dhe pastaj një ndarje tjetër edhe në nën-segmente, ka ndikuar pozitivisht në arritjen e rezultateve të parapara në planin e biznesit. Ky segmentim ka ndihmuar në fokusimin e personelit nëpër grupet e targetuara si dhe në hartimin e kampanjave specifike për të arritur deri tek ato grupe.



Banka ka arritur që të rris bazën e klientëve, kryesisht me klientë individual dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme, që ishin dhe mbasin fokusi ynë, mirëpo, në vitin 2014, ka pasur përmirësime edhe në shërbimet që iu janë ofruar korporatave.

Në vitin 2014, banka ka filluar edhe me financimin e sektorit të bujqësisë, që në të ardhmen konsiderohet të bëhet një nga shtyllat e fokusit të bankës.

Në përputhje me ndryshimet e bëra në produkte dhe shërbime, janë organizuar edhe trajnime dhe punëtori të ndryshme me personelin e degëve, në mënyrë që ata të jenë sa më të përgatitur në ofrimin e informatave për klientët dhe shërbimin ndaj tyre. Ngritja e shërbimit ndaj klientëve mbetet ndër prioritetet më të larta të bankës, e që sigurisht kjo ka ndikuar në rritjen e bazës së klientëve.

Viti 2014 ka qenë vit i ngritjes së kualitetit të disa prej shërbimeve elektronike, duke iu shtuar disa karakteristika që nuk kanë qenë në të kaluarën dhe që e bëjnë këtë produkt/shërbim edhe më të mirë për klientët, pavarësisht segmentit që ata i takojnë.

*në mijëra, aty ku aplikohet



●●●●● 2013 ●●●●● 2014



Rrjeti i degëve

Banka ka një numër të konsiderueshëm të degëve dhe nëndegëve, në të cilat mund të shërbehen klientët. Numri aktual i degëve ju mundëson klientëve një qasje të shpejtë dhe të lehtë në të gjitha produktet bankare. Viti 2014 ka qenë vit i riorganizimit të degëve dhe nëndegëve. Gjithashtu në këtë vit është aktivizuar edhe Qendra e Thirrjeve (Call Centre). Përmes kësaj qendre pranohen thirrjet e klientëve, mirëpo, në të njëjtën kohë bëhet edhe kontaktimi i klientëve për informacione të ndryshme.

Në vitin 2014, banka ka vazhduar me procesin e ridizajnit të degëve dhe ky proces do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm, me qëllim të standardizimit të rrjetit të degëve të bankës.





Teknologjia informative

Teknologjia informative

Banka ka realizuar disa projekte kapitale në fushën e teknologjisë informative gjatë vitit 2014. Disa që vlejné të cekën janë kalimi i gjithë platformës fizike në atë virtuale, kalimi në platformën Windows Server 2012, migrimi i të gjithë PC-ve në Windows 8, avancimi i administrimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik për ndërlidhjen e degëve me qendër, etj.

Disa nga veçoritë e platformës virtuale janë:

- Sistemi virtual ndryshe quhet edhe Green IT, për arsye se kursen energji elektrike;
- Mundësia e kthimit të shërbimeve të bankës nga ndonjë fatkeqësi, në mënyrë shumë më të shpejtë, pasi që me sistemin virtual, të gjithë serverët ruhen si imazh dhe kjo e bënë që i gjithë shërbimi i caktuar të ruhet si një dokument i vetëm.

Avancimi i rrjetit të brendshëm kompjuterik është arritur duke futur në përdorim pajisje të sofistikuara të rrjetit kompjuterik, që ngritin nivelin e sigurisë me përdorimin e algoritmeve dhe protokolleve të fundit të sigurisë.

Me këto avancime në fushën e teknologjisë informative, klientët e bankës tonë përfitojnë shërbime më të shpejta dhe më kualitative. Për më shumë, këto avancime bëjnë që banka të jetë në hap me trendët e fundit të teknologjisë informative.







Operacionet



Pagesat kombëtare dhe ndërkombëtare

Banka në vitin 2014 ka vazhduar të ofrojë për klientë e saj pagesa të brendshme dhe ndërkombëtare, në mënyrë të sigurt, efikase dhe të shpejtë.

Për realizimin e pagesave ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse ka qenë një ndihmesë e madhe anëtarësimi në Swift, sepse kjo ka mundësuar realizimin më të lehtë të komunikimit dhe trafikut për pagesa. Infrastruktura dhe shtrirja e rrjetit të bankës, ua ka mundësuar klientëve që ta kenë më të lehtë inicimin e pagesave ndërkombëtare, duke ua lehtësuar atyre mënyrat dhe duke ua kursyer kohën dhe shpenzimet.

Banka pos ofrimit të këtyre shërbimeve direkt në bankë, ka ngritur gjithashtu nivelin e inicimit të pagesave me e-banking, mjet ky, i cili është duke u shfrytëzuar çdo herë e më shumë nga klientët tanë, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar ka qenë stabil gjatë vitit 2014. Për të përmirësuar kualitetin e punës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullative gjatë vitit 2014, banka ka rishqyrtuar të gjitha politikat dhe procedurat operacionale në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës. Infrastruktura ligjore ka mundësuar që të veprojmë me efikasitet dhe në ngritjen e përgjegjshmërisë tek stafi operacional. Për më shumë, banka ka vazhduar me trajnimin e personelit, lidhur me biznesin dokumentar.

Thesari

Në vitin 2014, banka ka vazhduar me menaxhimin e parasë se gatshme, respektimin e limiteve, FX – aktivitetet si dhe aktivitetet e letrave me vlerë. Banka vazhdon të jetë aktive në ofertim në çdo ankand të shpallur të letrave me vlerë dhe obligimeve qeveritare dhe gjatë tërë vitit ka mbajtur një portfolio stabile. Pjesa me e madhe e investimeve në letra me vlerë dhe obligimeve qeveritare, është bërë në periudhat afatshkurta 3 mujore dhe 6 mujore.







Administrimi i kredive

Me qëllim të përmirësimit të procesit të punës dhe procesit të Operacioneve, banka në vitin 2014, ka ngritur një sektor të veçantë, i cili merret me administrimin e kredive. Ky sektor ka mbështetur dhe lehtësuar punën zyrtarëve të front office dhe njëkohësisht ka monitoruar punën e tyre, që të jenë më efikas dhe të ofrojnë shërbime më të mira dhe më të sigurta për klientët e bankës. Me krijimin e këtij sektori, banka ka pasur një shpërndarje më të shpejtë të kredive për klientë, ka pasur kontroll më të mirë dhe posaçërisht ky sektor, ka ndikuar në zbatimin e politikave dhe procedurave në përpikëri.

Menaxhimi i rrezikut





Menaxhimi i rrezikut kreditor

Rreziku klasik kreditor, (do të thotë rreziku që huamarrësit nuk do të jenë në gjendje t'i përmbushin detyrimet e tyre me kontratë ndaj bankës ose do të jenë në gjendje t'i përmbushin ato vetëm pjesërisht), është rreziku më i rëndësishëm me të cilin përballlet banka.

Gjatë vitit 2014, banka ka bërë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e shumë proceseve në menaxhimin e riskut kreditor si:

- Centralizimi i procesit të shqyrtimit të pjesës më të madhe të kërkesave kreditore, duke përfshirë këtu dhe centralizimin e procesit të shpërndarjes së kredive;
- Rritja e dukshme dhe kualitative e monitorimit/kontrollit;
- Avancimi i procesit të vlerësimit të aplikacioneve kreditore;
- Përmirësim i dukshëm i infrastrukturës ligjore dhe procedurale të disa aktiviteteve;
- Përmirësim të dukshëm në kualitetin e portfolios kreditore;
- Aktivitetet e shumta dhe intensive në përmirësimin e procesit të marrjes prapa të borxheve të këqija dhe parandalimin e rasteve të reja.

Qëllimi kryesor strategjik i bankës është që të vazhdojë me rritjen e saj të qëndrueshme dhe cilësore, duke rritur gradualisht pjesëmarrjen aktuale të tregut.

Menaxhmenti i bankës është dhe do të jetë i fokusuar në përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e portfolios kreditore me risk kreditor, të shpërndarë gjithmonë duke konsideruar menaxhimin e kostos së aktivitetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Menaxhimi i këtij lloji rreziku nga banka, bëhet përmes një infrastrukture të avancuar të politikave dhe procedurave efektive të saj. E gjithë kjo infrastrukturë është e krijuar në përputhje me kërkesat nga institucionet mbikëqyrëse dhe rregullative.

Diversifikimi i portfolios kreditore të bankës dhe ngritja kualitative e saj, viteve të fundit ka bërë të mundur që rrjedhat hyrëse të parave të gatshme të jenë të parashikueshme. Portfolio e depozitave të klientëve është diversifikuar në një numër të madh depozituesish me shuma relativisht më të vogla. Në baza të rregullta, banka përcjell koeficientët dhe indikatorët e saj të likuiditetit, të përcaktuar paraprakisht.

Në kuadër të procesit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, bëhen edhe stres teste të likuiditetit në baze të metodologjive dhe skenarëve të përcaktuar nga banka, teste të cilat ndihmojnë bankën për të analizuar gjendjen e saj në raste të lëvizjeve potenciale të brendshme apo të jashtme.

Banka gjatë vitit 2014, është karakterizuar me një nivel të kënaqshëm të likuiditetit i përcjellë me një shkallë të lartë të mjeteve të saj likuide.



Menaxhimi i rrezikut të valutës dhe normës së interesit

Rreziku i valutës së huaj menaxhohet nga banka në pajtim me politikën e menaxhimit të rrezikut të valutës së huaj, që respekton kërkesat e rregullores së BQK-së për rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja.

Banka ka një nivel të ulët të ekspozimit ndaj rrezikut të valutës, sepse ajo nuk i mban pozitat e hapura të valutës në mënyrë spekulative.

Pozitat e valutës menaxhohen në baza ditore dhe normat e këmbimit të valutave të huaja monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. Banka ka përcaktuar limite të lejuara për këtë rrezik, të cilat çdo herë janë në përputhshmëri me kriteret e brendshme dhe të jashtme.

Limitet e brendshme të parapërcaktuara nga banka për të menaxhuar këtë lloj rreziku, nuk janë thyer asnjëherë gjatë vitit 2014.

Menaxhimi i rrezikut operacional

Rreziku operacional definohet si rrezik që vjen nga dështimi apo puna joadekuate: të proceseve të brendshme në Bankë, njerëzve apo sistemeve dhe/ose ngjarjeve të jashtme.

Banka bazohet në praktikën e shëndosha për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut operacional, të propozuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare.

Ne këtë aspekt objektivat dhe qasja e Bankës në menaxhimin e rrezikut operacional është që:

- Të kuptojë indikatorët kryesor të rrezikut operacional;
- Të kontrolloj dhe të menaxhoj çfarëdo çështje kritike, sa më parë që është e mundur;
- Të parandaloj humbjet që vijnë nga rreziku operacional.

Gjatë vitit 2014, banka ka bërë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e shumë proceseve në menaxhimin e riskut operacional si:

- Implementimin e kontrollit në aktivitete të ndryshme operacionale;
- Ndërtimin e infrastrukturës për identifikimin, evidentimin dhe menaxhimin e humbjeve operacionale të bankës;
- Trajnime dhe ngritje e përgjegjësisë së stafit mbi raportimin e ngjarjeve, të cilat përmbajnë risk operacional.

Banka investon në mënyrë të vazhdueshme në arritjen e standardeve të larta të sigurisë, sa i përket teknologjisë informative. Për më tepër, banka ka përgatitur një plan konkret për trajnimin e stafit mbi të gjitha aktivitetet bankare, duke ndikuar kështu në parandalimin e rreziqeve të mundshme.

The image features a blurred background of several people in a professional setting, possibly a meeting or conference. The scene is overlaid with a semi-transparent orange filter. A diagonal line separates the orange-tinted area from a clearer, white-tinted area in the top right corner. The text 'Burimet njerëzore' is centered in the white area.

Burimet njerëzore



Strategjia e burimeve njerëzore

Një ndër objektivat kryesore të bankës në vitin 2014, ishte zhvillimi i personelit.

Banka ka përgjegjësi profesionale ndaj personelit dhe kjo dëshmohet me investimet tona të vazhdueshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale për të gjithë punëtorët. Për më shumë, kjo ngritje profesionale e personelit ndihmon që komunikimi me klientë të jetë korrekt dhe efektiv, duke ndihmuar kështu arritjen e rezultateve pozitive.

Një ndër iniciativat që banka ka ndërmarr në vitin 2014, është edhe organizimi i trajnimeve me kapacitetet ekzistuese menaxheriale, me qëllim të përsosjes së njohurive të personelit të saj mbi gamën e gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare. Gjatë këtij viti pothuajse i tërë personeli, i cili është i angazhuar në operimet e degës, ka kaluar në fazën e trajnimeve të cekura më lartë.

Poashtu, përveç ngritjes profesionale me anë të trajnimeve të brendshme në vitin 2014, banka ka organizuar edhe trajnime të jashtme, të cilat janë organizuar nga partnerët tjerë afaristë, të cilët kanë ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve në nivelin qendror.

Me anë të organizimit të fokus-grupeve brenda bankës është ndihmuar mjaftë në promovimin e komunikimit të hapur dhe konfrontimi transparent, i cili ka ndihmuar në pasurimin e proceseve brenda sektorit të burimeve njerëzore, që ai të jetë sa më afër kërkesave institucionale.

Banka, me shumë seriozitet dhe përkushtim do të vazhdoj në realizimin dhe organizimin e mundësive të ndryshme të trajnimeve brenda institucionit si dhe me partnerët e saj afarist.



Përgjegjësia sociale e korporatës

Përgjegjësia sociale e korporatës është përgjegjësi e çdo biznesi që të sillet me etikë, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës së punëtorëve, komunitetit lokal dhe shoqërisë në përgjithësi.

Një ndër prioritetet e bankës është përgjegjësia sociale, duke ofruar ndihmë modeste për komunitetin.




Projektet e përkrahura

Shpërndarja e topave në shkollat e Kosovës

Duke pas parasysh që edukimi dhe shëndeti i fëmijëve tonë është parësor, banka ka organizuar shpërndarje të topave tejet cilësorë, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, me përkrahjen e secilës Komunë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, International Relief and Development (IRD-së) dhe Sport Sans Frontiers (SSF-së).

One to One Children's Fund

Në vazhdimësinë e përkrahjes së fëmijëve, në vitin 2014, banka ka ndihmuar Qendrën "Pema". Kjo qendër përkujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ne kemi ndihmuar që infrastruktura në këtë qendër, të përmirësohet në mënyrë që fëmijët që vijojnë këtë institucion, të kenë kushtet më të mira të mundshme.





Banka për Biznes sh.a

Raporti i audituesve të pavarur dhe pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor, 2014



KPMG Albania Sh.p.k., Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristine, Kosovo

Telephone +381(38)246771
Telefax +381(38)246772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Ky përkthim është vetëm për qëllime informimi. Varianti anglisht i cili është edhe origjinali ka prioritet mbi të.

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionarëve dhe Bordit të Drejtuesve të
Banka Per Biznes Sh.a

Prishtinë, 30 Mars 2015

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Banka Per Biznes Sh.a ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimeve në ekuitet dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014, rezultatit e saj financiar dhe rrjedhjen e parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k., Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristine, Kosovo


Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Përmbledhëse
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

<i>Në mijë EUR</i>		Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
	Shënimet		
Të ardhurat nga interesi		9,013	9,102
Shpenzimet e interesit		(2,556)	(4,037)
Të ardhurat neto nga interesi	6	6,457	5,065
Të ardhurat nga tarifa dhe provizioni		1,999	1,647
Shpenzimet e tarifës dhe provizionit		(399)	(249)
Të ardhurat neto nga komisionet dhe tarifat	7	1,600	1,398
Kreditë e mbledhura që janë shlyer më herët		465	352
Fitimi neto nga këmbimi valutor		25	10
Të ardhurat e tjera operative		69	102
Gjithsej të ardhurat operative		8,616	6,927
Provizionet për humbjet e kredive	14	(2,059)	(1,593)
Kthimi/(ngarkesa) nga provizioni per kerkesa ndaj garancioneve	16	10	(123)
Provizionet për letër garancionet e lëshuara nga Banka		(4)	(16)
Provizionet për aktivet joqarkulluese të mbajtura për shitje	15	(241)	(51)
Shpenzimet e tjera operative	8	(4,793)	(5,034)
Gjithsej shpenzimet operative		(7,087)	(6,817)
Fitimi para tatimit në fitim		1,529	110
Shpenzime për tatime	9	(17)	(88)
Fitimi neto për vitin		1,512	22
Të ardhurat e tjera përmbledhëse		-	-
Gjithsej të ardhurat përmbledhëse për vitin		1,512	22

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
 Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

<i>Në mijë EUR</i>		Më 31	Më 31
	Shënimet	Dhjetor 2014	Dhjetor 2013
Aktivët			
Paratë e gatshme dhe në banka	10	7,881	7,947
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	11	20,891	16,973
Kreditë dhe paradhëniet për banka	12	1,870	2,146
Investimet e mbajtura deri në maturitet	13	7,242	16,048
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	14	74,979	68,116
Aktivët jo qarkulluese të mbajtura për shitje	15	843	1,230
Aktive të tjera	16	708	117
Aktivët e patrupëzuara	17	145	247
Prona dhe pajisjet	18	642	658
Gjithsej aktivët		<u>115,201</u>	<u>113,482</u>
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	19	103,003	100,817
Huamarrjet	20	1,800	1,800
Detyrimet e tatimit të shtyrë	9	105	88
Detyrimet e tjera	21	535	2,627
Gjithsej detyrimet		<u>105,443</u>	<u>105,332</u>
Kapitali			
Kapitali aksionar	22	11,247	11,247
Rezervat tjera të kapitalit	22	857	857
Rezerva e rivlerësimit	22	96	-
Humbjet e akumuluar		(2,442)	(3,954)
Gjithsej kapitali		<u>9,758</u>	<u>8,150</u>
Gjithsej detyrimet dhe kapitali		<u>115,201</u>	<u>113,482</u>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës më datën 30 Mars 2015 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:


 Richard Beasley
 Kryeshf Ekzekutiv


 Avni Berisha
 Udhëheqës i Divizionit të
 Financave

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e ndryshimeve ne Kapital

<i>Në mijë Euro</i>	Kapitali akionar	Rezervat tjera të kapitalit	Rezerva e rivlerësimit	Humbjet e akumuluar	Gjithsej
Gjendja me 1 Janar 2014	11,247	857	-	(3,954)	8,150
Kontribute dhe shpërndarje					
Rezerva e rivlerësimit	-	-	96	-	96
Fitimi I vitit	-	-	-	1,512	1,512
Të ardhurat tjera përmbledhëse	-	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat tjera përmbledhëse	-	-	-	1,512	1,512
Më 31 Dhjetor 2014	11,247	857	96	(2,442)	9,758
Gjendja me 1 Janar 2013	11,247	857	-	(3,976)	8,128
Kontribute dhe shpërndarje					
Fitimi I vitit	-	-	-	22	22
Të ardhurat tjera përmbledhëse	-	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat përmbledhëse	-	-	-	22	22
Më 31 Dhjetor 2013	11,247	857	-	(3,954)	8,150

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë
Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

<i>Në mijë EUR</i>	Shënimet	2014	2013
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		1,529	110
<i>Zërat jo-në para të gatshme në pasqyra financiare:</i>			
Zhvlerësimi	18	267	374
Amortizimi	17	109	39
Humbje nga dalja nga përdorimi i aktiveve afatgjata të trupezuara		(82)	(186)
Fitimet nga këmbimi i valutës së huaj		(25)	(10)
Provizionet për humbjet e kredive	14	2,059	1,593
Provizionet për kërkesat ndaj garancioneve	16	(10)	123
Provizionet për letër garancionet të lëshuara nga Banka	21	4	16
Provizioni për aktivet joqarkulluese të mbajtura për shitje	15	241	51
Të ardhurat neto të interesit nga klientët dhe bankat	6	(6,457)	(5,065)
		(2,365)	(2,955)
Ndryshimet në:			
Kredi dhe paradhënie me bankat	12	(384)	1,512
Kredi dhe paradhënie me klientët	14	7,511	8,103
Kredi të fshira	14	(1,442)	(5,232)
Rezerva statutore në BQK	11	(221)	618
Aktive të tjera	16	(591)	(62)
Bruto aktivet jo qarkulluese të mbajtura për shitje	15	166	(256)
Neto depozitat nga klientët	19	2,186	(8,770)
Detyrimet e tjera	21	(2,091)	2,038
Interesi i arkëtuar		9,013	9,102
Interesi i paguar		(2,556)	(4,037)
Paraja neto (shfrytëzuar në)/nga aktivitetet operative		(5,796)	61
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e investimeve të mbajtura deri në maturitet	13	8,806	(645)
Blerja e pasurive dhe paisjeve	18	(159)	(264)
Blerja e aktiveve të patrupëzuara	17	(7)	(56)
Shitja e pasurive dhe paisjeve		127	161
Paraja neto/(shfrytëzuar) në aktivitetet investuese		8,767	(804)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Ripagesa të huave	20	-	(4,286)
Marrja e huasë së re	20	-	1,800
Paraja neto e shfrytëzuar në aktivitetet financuese		-	(2,486)
Rritja/(Pakësimi) neto i parasë dhe ekuivalentët e saj		2,971	(3,229)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	23	18,911	22,140
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	23	21,882	18,911

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***1. Hyrje**

Në përputhje me rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka Private e Biznesit Sh.a ("BPB") e ka marrë licencën për aktivitetet bankare me 29 mars 2001, dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001. Pas vendimit të Bordit të Drejtorëve të datës 28 shkurt 2005 dhe nga miratimi final nga BQK-ja me datë 22 mars 2005, BPB-ja e ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit ("BPB") në Banka për Biznes ("Banka"). Që nga 31 dhjetori i vitit 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a") në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës. Banka operon si një bankë komerciale dhe për kurseme për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve të saj në: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan dhe 20 (njetetë) nëndegë të vendosura nëpër tërë Kosovën (2013: 32).

2. Bazat e përgatitjes**(a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç pronësive të caktuara që janë të matura me shumat e rivlerësuara ose vlerat e drejta, siç shpjegohet në politikat e kontabilitetit më poshtë.

(c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro ("EUR") e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç kur tregohet ndryshe, informacioni financiar i paraqitur në EUR është i rrumbullakuar në mijëshen e afërt.

(d) Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, manaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshim nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementët e rëndësishëm me pasiguri në vlerësime dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4.

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja janë njohur dhe kthyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në monedhën funksionale të Bankës me kursin në datën e raportimit.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(a) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kosës së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kosës së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit. Aktivet jo-monetare dhe pasive në monedhën të huaj që maten me vlerën e drejtë duhet të konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Dallimet në monedhën të huaj që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje. Monedhat e huaja me të cilat merret Banka janë kryesisht Dollari Amerikan USD, Frangu Zviceran (CHF) dhe Funta e Britanisë së Madhe (GBP). Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

MONEDHA	2014 EUR	2013 EUR
1 USD	0.8237	0.7251
1 CHF	0.8317	0.8145
1 GBP	1.2839	1.1994

(b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrret pagesat dhe arkëtimet e ardhshme, përgjatë jetës së pritshme të aktivit financiar ose pasivit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivit financiar ose pasivit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

(c) Komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Kur një zotim për kredi nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e një kredie, tarifat e zotimit të kredisë janë njohur në bazë lineare përgjatë periudhës së zotimit.

Të ardhura e tjera nga tarifa, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve, si dhe provizionet e shitjeve dhe tarifat e vendosura janë të njohura me rastin e kryerjes së shërbimeve përkatëse.

Shpenzime dhe provizionet e tjera lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet janë kryer.

(d) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Pranimet e nxitësve të qirasë njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë, përgjatë afatit të qirasë.

Pagesat e qirave të kushtëzuara llogariten duke rishikuar pagesat minimale të qirasë mbi periudhën e mbetur kur rregullimet e qirasë janë konfirmuar.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(e) Shpenzimet për tatimin në të ardhurat**

Shpenzimet e tatimit në të ardhura përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimet e tatimit në të ardhura njihet në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhen me zërat e njohur direkt në kapital, ku në këtë rast njihen në kapital ose në të hyrat tjera gjithpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur nga diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të mjeteve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, në bazë të ligjeve që janë fuqi ose që konsiderohet nga deklarata e datës së raportimit.

Një mjet tatimor i shtyrë njihet vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme kundër të cilave mund të shfrytëzohet ky mjet. Mjetet e tatimit të shtyrë janë rishikuar në secilën datë të raportimit dhe janë reduktuar në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare*(i) Njohja*

Banka fillimisht nje huatë dhe paradhënie, investimet e mbajtura deri ne maturim, depozitat, dhe borxhin e varur në datën që ato janë emetuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet e shitjet e rregullta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të vendosura nga marrëveshjet e tregut përkatës ose entiteti rregullator) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus, për një zë me vlerën jo të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo lëshimin e tij.

*(ii) Klasifikimi***Aktivët financiarë**

Banka klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme; dhe
- Të mbajtura deri ne maturim

Shiko shënimet 3(g) deri 3(j)

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare (përveç garancive dhe angazhimeve për hua) si të matura me kosto te amortizuar. Shih shënimin 3(k).

*(iii) Çregjistrimi***Aktivët financiarë**

Banka çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose ajo transferon të drejtat për të marrë flukse mjetesh monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(f) Aktivët financiarë dhe detyrimet financiarë (vazhdim)**

Në momentin e çregjistrimit të një aktivi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto të aktivit (ose vlera kontabël që i përket pjesës së aktivit të transferuar), dhe totalit të (i) konsideratës së marrë (përfshirë çdo aktiv të ri të përftuar ose detyrim të supozuar) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (ATP), njihet në fitim ose humbje. Çdo interes i transferuar me aktivet financiare të kualifikuara për çregjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka, njihet si aktiv ose detyrim i veçantë.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen apo anulohen, ose skadojnë.

(iv) Kompensimi

Aktivët dhe detyrimet financiarë kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompesuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

(v) Matja me kosto të amortizuar

‘Kostoja e amortizuar’ e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

‘Vlera e drejtë’ është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose pasivi të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me aktivin apo detyrimin ndodhin me shpeshtësi e volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin. Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet. Nëse një aktiv ose pasiv matur me vlerën e drejtë ka çmim të ofruar dhe çmim të kërkuar, Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim të kërkuar.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)***(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)*

Vlera e drejtë e një llogarie nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë kur mund të kërkohej pagimi i shumës. Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur.

*(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit***Zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve**

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiarë është zhvlerësuar kur evidencat objektive demonstronin se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të aktivitetit ose grupeve të aktiveve dhe që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit, mospagesa nga huamarrësit, ristrukturimin e një kredie apo paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do t'i kishte konsideruar, indikacione që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesit në grup, apo kushtet ekonomike që tregojnë me dështimin në grup.

Banka konsideron mundësinë e provizionimit për kreditë dhe paradhëniet dhe të investimeve të mbajtura deri në maturitet në nivel individual dhe kolektiv. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme dhe investimeve të mbajtura deri në maturitet vlerësohen në nivel individual. Kreditë e tjera vlerësohen në nivel kolektiv për ndonjë provizion të ndodhur por të paidentifikuar ende. Kreditë dhe paradhëniet dhe të Investimeve të mbajtura deri në maturitet që nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen në nivel kolektiv duke grupuar bashkë kreditë dhe paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturitet me karakteristika të ngjashme të rrezikut.

Humbja nga provizionimi i aktiveve e matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë në mes të vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit.

Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi kundrejt huave dhe paradhënieve.

Kreditë shlyhen pasi janë ndërmarrë masat e arsyeshme të mbledhjes në përputhje me politikën e Bankës. Kur një ngjarje pasuese shkakton që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, atëherë ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.

(g) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartmonedha në arkë, gjendja në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(h) Rezerva e detyrueshme e likuiditetit**

Në pajtim me rregullat e BQK-së, Banka duhet të plotësojë kërkesat për minimumin mesatar të likuiditetit. Kërkesa e likuiditetit është kalkuluar në baza javore si 10% e bazës së depozitave e definuar si mesatare e gjithsej depozitave të publikut jo bankar në Euro dhe valuta tjera, mbi ditët e punës të periudhës së mirëmbajtjes. Aktivet me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në euro me BQK-në dhe 50% të ekuivalenteve në Euro të parave të gatshme të monedhave lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme. Përderisa aktivet likuide respektive nuk janë në dispozicion për të financiar aktivitetet e ditë përditshme të Bankës ato janë përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentet e saj për qëllime të rrjedhës së parasë.

(i) Investimet e mbajtura deri në maturitet

Investimet e mbajtura deri në maturim, janë aktive jo derivative me pagesa të përcaktuara apo fikse dhe me një maturim fiks që banka ka qëllimin dhe mundësinë ti mbaje ato deri në maturim dhe të cilat nuk janë përcaktuar si vlerë e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes apo si mjete të gatshme për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturitet mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

Një shitje ose riklasifikim i një shume të investimeve të mbajtura deri në maturitet që është më shumë se jomateriale do të rezultonte në reklasifikimin e investimeve të mbajtura deri në maturitet në të gatshme për shitje, dhe do ta parandalonte Bankën nga klasifikimi i letrave me vlerë si të mbajtura deri në maturitet për vitin aktual dhe për dy vitet e ardhshme.

(j) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv. Kreditë dhe të arkëtueshmet të bankat dhe kreditë dhe të arkëtueshmet të klientët janë klasifikuar si kredi dhe të arkëtueshme.

Të gjitha kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke qenë të holla që janë dhënë të kredimarrësit. Pas njohjes fillestare, këto maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo kosto në disbursim dhe ndonjë zbritje ose prim të vendosur.

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë raportuar neto nga provizionet për humbje nga kreditë.

(k) Depozitat dhe huazimet

Depozitat dhe huazimet janë burimet kryesore të Bankës për financim.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo), marrëveshja kontabilizohet si një detyrim financiar, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës. Depozitat dhe huazimet maten me vlerën e drejtë minus koston direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(l) Prona dhe pajisje

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimet.

Kosto historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit. Programi kompjuterik i blerë që është thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(l) Prona dhe pajisje (vazhdim)**

Kur pjesë të një kategorie të mjeteve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve.

Shpenzimet e mepasshme njihen vetem nese është e mundshme qe perfitimet ekonomike qe i atribuohen atyre do te rrjedhin te Banka ne te ardhmen si dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Te gjitha kostet e tjera per riparime dhe mirembajtje i ngarkohen shpenzimeve operative te periudhes ne te cilen kryhen.

Vlera kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, rishikohet për të përcaktuar zhvlerësimin kur ka ndryshime në ngjarjet të cilat tregojnë se vlera e mbaratur nuk mund të rrekuperohet. Nëse ka të dhëna të tilla, dhe vlera kontabel është më e madhe se vlera që pritet të rrekuperohet, aktivet ose njësite gjeneruese të mjeteve monetare zhvlerësohen në vlerën e tyre të rrikuperueshme..

Shuma e rrikuperueshme e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, është vlera më madhe mes vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së përdorimit. Për të përcaktuar vlerën e përdorimit, flukset e pritshme të mjeteve monetare skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton një vlerësim aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rezikun që lidhet me këtë lloj aktivi.

Zhvlerësimi i Aktiveve ngarkohet në baza lineare në norma të përshkruara për alokimin e kostos së pronës dhe pajisjeve përgjatë jetës së tyre të përlloritur të dobishmërisë. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen nga jeta e përlloritur e dobishmërisë së Aktiveve të caktuara sipas tabelës në vijim:

- Ndërtesat - 20 vite
- Përmirësimet në objektet e marra me qira - periudha e kontrates /5 vite
- Pajisjet elektronike - 5 vite
- Automjetet - 5 vite
- Mobilet, pajisjet dhe stabilimentet - 5 vite

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura janë ri-vlerësuar në datën raportimit

(m) Aktive të pa trupëzuara

Aktivitet të patrupëzuara regjistrohen nëse është e provueshme se te mirat e ardhshme ekonomike të cilat vijne prej këtij aktivi do të perfitohen nga Banka dhe kostoja e aktivitet mund të matet në mënyrë të besueshme. Aktivitet e qëndrueshme të patrupëzuara janë matur fillimisht me kosto. Vlerat e mbartura të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara janë rishikuar për zhvlerësim kur ka ngjarje ose ndryshimet në rrethana të cilat tregojnë se vlerat e mbartura mund të mos jenë të rrikuperueshme. Aktivitet të patrupëzuara janë tërësisht të përbëra nga programi kompjuterik të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës se dobishme prej pesë vjetësh.

(n) Aktivitet afatgjata të mbajtura për shitje

Aktivitet afatgjata të mbajtura për shitje përbëhen nga pronat ku banka ka marrë titullin/pronësinë për ti shpaguear bankës borxhet e pashlyera. Vlera e drejtë e këtyre mjeteve në momentin e njohjes përcaktohet nga vlerësuesit e brendshëm të Bankës, dhe pastaj nga vlerësuesit e pavarur te pasurisë. Këto aktive skontohen mëpas varësisht prej vendndodhjes, mirëmbajtjes, moshës dhe kushtet për të pasqyruar vonesa në rregullime të mundshme dhe kohën që e ka mbajtur Banka aktivin.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(o) Rënja në vlerë e aktiveve jo financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të bankës, përveç aktiveve për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të saj e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme. Një njësi gjeneruese të aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e të hollave të ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin apo njesinë gjeneruese të parasë. Për qëllime të testimit të dëmtimit, aktivitetet janë grupuar në grupe më të vogla të aktiveve që gjenerojnë para nga shfrytëzimi i vashdueshëm dhe që janë shumë të varura nga gjenerimi i parasë nga aktivitetet tjera apo njësitë tjera gjeneruese të parasë.

Humbjet nga dëmtimi janë njohur në fitim apo humbje. Humbjet nga dëmtimi janë alokuar në baza proporcionale.

(p) Provizionet

Provizioni njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi, dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohej për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritura të aktiveve monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe, sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Diskontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

(q) Përfitimet e punonjësve

Banka i bën të detyrueshme vetëm kontributet e sigurimit social që mundësojnë përfitime për punonjësit me rastin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë nën një plan të përcaktuar të kontributeve pensionale. Kontributet e bankës ndaj planit pensional ngarkohen në fitim apo humbje sipas kohës kur ndodhin.

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime me momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi me ç'rast detyrimi mund të vlerësohet me saktësi

(r) Garancitë financiare dhe angazhimet për hua

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të para-përcaktuara.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)****(s) Kapitali aksionar*****Dividentët***

Dividendët janë regjistruar si detyrime në periudhën në të cilën ato janë të deklaruar.

(t) Standarde të reja dhe amendime ende të pa adoptuara

Një numër standardesh, amendimesh dhe interpretimesh nuk kanë qënë ende efektive në fund të 31 Dhjetorit 2014 dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato që mund të jenë me rëndësi për Bankën janë paraqitur si më poshtë. Banka nuk planifikon të adoptojë këto standarde dhe amendime më herët.

SNRF 9 Instrumentat Financiarë

SNRF 9 i publikuar në Korrik 2014, zëvendeson interpretimin aktual në SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Vlerësimi. SNRF 9 përfshin interpretim të reviduar mbi klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë modelin e ri të pritjes së humbjeve kreditore për kalkulimin e zhvlerësimit të mjeteve financiare, dhe kërkesat e përgjithshme të reja për kontabilitetin e ngurtësuar (hedge). Ky standard gjithashtu sjell interpretim të njohjes dhe mosnjohjes së mjeteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 është efektive për periudhat vjetore të raportimit duke filluar nga apo pas 1 Janarit 2018, me leje adoptimi edhe më herët.

Banka ka filluar procesin e vlerësimit të ndikimit potencial në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga aplikimi i SNRF 9. Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetëve të bankës, ky standard pritet të ketë ndikim gjithëpërfshirës në pasqyrat financiare të bankës.

IFRS 15 Te hyrat nga kontratat me kliente

SNRF 15 krijon një strukturë gjithëpërfshirëse për të përcaktuar se sa, dhe kur e hyra duhet të njihet. Ky standard zëvendeson interpretimin aktual të njohjes së të hyrave, duke përfshirë SNK 18, Të hyrat, SNK 11 Kontratat e ndërtimit dhe IFRIC 13 Programet e lojalitetit të klientëve. SNRF 15 është efektive për raportime vjetore për periudhat nga ose pas 1 Janar 2017, me lejm të adoptimit të mëhershëm. Banka po vlerëson ndikimin potencial në pasqyrat e saj financiare nga aplikimi i SNRF 15.

Standardet e rregulluara apo të reja si më poshtë nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës:

- Planet e definuara të përfitimit: Kontributet e punëtorëve (Rregullimet të SNK 19).
- SNRF 14 Llogaritë e Shtyera të Rregullatorit.
- Kontabiliteti për përvetsimin e interesit në aktivitetet e përbashkëta (Rregullimet të SNK 16 dhe SNK 38).
- Bujqësia: Bartësit e plantacioneve (Rregullimet të SNK 16 dhe SNK 41)
- Metoda e Ekuitetit në Pasqyra financiare të ndara (Rregullimet të SNK 27)
- Shitja apo kontributi i mjeteve në mes të investitorit dhe ortakërisë së tij (Rregullimet të SNRF 10 dhe SNK 28).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Menaxhmenti ka diskutuar me Bordin e Drejtorëve për zhvillimin, përzgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe përllogaritjeve kryesore kontabël të Bankës, si dhe aplikimin e këtyre politikave dhe përllogaritjeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e riskut financiar (shih shënimin 26).

Burimet kryesore të vlerësimit të pasigurisë***Provizionet për humbjet nga kreditë***

Aktivet e llogaritura me kosto të amortizuara vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave të përshkruara të kontabilitetit 3 (f) (vii).

Komponenti specifik i palës së kundërt në totalin e provizionimit për zhvlerësim që aplikohet për kreditë dhe paradhëniet për klientët e vlerësuar individualisht për provizionim është i bazuar mbi vlerësimin më të mirë të vlerës aktuale të flukseve monetare që pritet të pranohen. Për të vlerësuar këto flukse të parave, menaxhmenti gjykon mbi bazën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të pengut garantues. Secili aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, strategjisë së punës dhe llogaritjes së parave që konsiderohen të arkëtueshme dhe aprovohet në mënyrë të pavarur nga Komiteti për Riskun e Kredisë.

Provizionet e vlerësuara në mënyrë të përgjithësuar për humbje i mbulojnë humbjet e kredive të pandara në portfoliot e kredive dhe paradhëniet për klientët me karakteristika të ngjashme ekonomike kur ka prova objektive që sugjerojnë se ato përmbajnë indikacione për humbje, mirëpo ende nuk mund të identifikohen zhvlerësimet individuale të aktiveve. Në vlerësimin e provizioneve të përgjithshme të humbjes së kredive menaxhmenti merr në konsideratë faktorë të tillë si cilësia e kredisë, madhësia e portfolit, përqendrimet dhe faktorët ekonomik.

Në mënyrë që të vlerësohen provizionet e duhura, bëhen supozime për të definuar mënyrën se si humbjet e qenësishme janë modeluar edhe për të përcaktuar parametrat e të dhënave të kërkuara, bazuar në përvojën historike dhe kushtet aktuale ekonomike.

Saktësia e provizioneve varet se sa mirë janë të përdorura këto flukse të ardhshme monetare për provizionet e respektive dhe modelet e gjykimeve dhe parametrat e përdorur në përcaktimin e provizioneve kolektive.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë e cila reflekton fuqinë e faktorëve të shfrytëzuar në arritjen e vlerësimeve.

Niveli 1: Faktorët që janë vlerësuar me çmime të tregut (të parregulluar) në tregje aktive për instrumentet identike.

Niveli 2: Faktorët tjerë nga çmimet e tregut të përfshirë në nivelin 1 të cilët janë të vëzhgueshëm drejtëpërdrejtë (p.sh si çmime) apo në mënyrë indirekte (psh, te derivuara nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngjashme apo identike në tregjet të cilat konsiderohen më pak se aktive; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në mënyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhenat e tregut.

Niveli 3: Faktorët që janë të pa vëzhgueshëm. Kjo kategori përfshinë të gjithë instrumentët për të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë faktor që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën neto të tanishme dhe modelet e diskontimit të rrjedhës së parasë së gatshme, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat çmimet e vëzhgueshme të tregut ekzistojnë, dhe modele tjera të vlerësimit.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)*****Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)***

Gjykimet dhe faktorët e shfrytëzuar në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit të tregut dhe ato pa rrezik, rrezikun kreditor, dhe faktorët e tjerë të shfrytëzuar për të përlllogaritur normat e diskontimit, çmimet e bondeve dhe të ekuitetit, normat e këmbimeve valutore për valutat e huaja çmimet e ekuitetit dhe indeksit të ekuitetit, dhe parashikimet e ndjeshmërisë dhe ndërlidhjeve të çmimeve.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrihet deri te një përcaktim i një vlere të drejtë që reflekton çmimin i cili do të pranohej me rastin e shitjes së një mjeti apo që do të paguhej për të shlyer një detyrim në një transaksion normal ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e vlerësimit.

Aktivet	2014		2013	
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
Kredi dhe paradhënie për bankat	1,870	1,870	2,146	2,146
Kredi dhe paradhënie për klientët	74,979	73,222	68,116	67,415
Investimet e mbajtura deri në maturitet	7,242	7,242	16,048	16,048
	84,091	82,834	86,310	85,609
Detyrimet				
Depozitat e klientëve	103,003	103,371	100,817	101,176
Huazimet	1,800	1,534	1,800	1,534
	104,803	104,905	102,617	102,710

Vlera e drejtë për mjetet dhe detyrimet financiare më lartë është përcaktuar duke shfrytëzuar Nivelin 2 të faktorëve të përshkruar më lartë.

5. Krahasimet

Informatat krahasuese prezantohen vazhdimisht mbi zbatimin e politikave kontabël të bankës.

6. Të ardhurat neto nga interesi

Të hyrat neto nga interesi përbëhen si në vijim:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Të ardhurat neto nga interesi:		
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	8,917	8,864
Kreditë dhe paradhëniet për banka	5	11
Investimet e mbajtura deri në maturitet	91	227
	9,013	9,102
Shpenzimet e interesit:		
Depozitat nga klientët	(2,373)	(3,824)
Huamarjet	(183)	(213)
	(2,556)	(4,037)
Të ardhurat neto nga interesi	6,457	5,065

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***7. Të ardhurat neto nga tarifët dhe provizionet**

Të ardhurat nga tarifët dhe provizionet në vlerë prej 1,999 mijë Euro për vitin 2014 (2013: 1,647 mijë Euro) paraqesin të hyrat e gjeneruara nga shërbimet bankare të ofruara për klientë dhe i referohen transfereve të parasë, aktiviteteve kredidhënëse, garancioneve si dhe tarifët tjera të shërbimeve bankare. Shpenzimet e tarifave dhe provizioneve në vlerë prej 399 mijë Euro për vitin 2014 (2013: 249 mijë Euro) i referohen shërbimeve bankare të ofruara nga bankat korrespondente.

8. Shpenzimet e tjera operative*Shpenzimet operative përbëhen si në vijim:*

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzimet e personelit	2,173	2,172
Qiraja	718	797
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	376	413
Sigurimi dhe siguria fizike	324	411
Shërbimet komunale dhe karburanti	171	184
Riparimet dhe mirëmbajtja	148	131
Komunikimi	141	171
Konsulenca	111	104
Shpenzimet e procesimit të kartelave	104	109
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	91	93
Shpenzimet e pastrimit	54	68
Materialet për zyre	51	55
Shpenzimet e anëtareve të bordit	23	24
Udhëtimi	8	18
Shpenzimet e tjera	300	284
Gjithsej	4,793	5,034

Numri i të punësuarve më 31 Dhjetor 2014 është 276 (31 Dhjetor, 2013: 279).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***9. Shpenzimet e tatimit fitimit dhe tatimi i shtyrë**

Shpenzimet e tatimit fitimit përbehen si në vijim:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Tatimi mbi fitimin aktual	-	-
Tatimi i shtyrë (përfitim)/shpenzimi	17	88
	17	88

Tatimi në rezultatet e bankës para tatimit ndryshon nga shuma teorike që do të vinte duke shfrytëzuar normën e mesatares së ponderuar të tatimit e aplikueshme në fitimet e bankës sikurse më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	1,529	110
Tatimit i kalkuluar sipas normës tatimore 10%	152	11
Shpenzimet e pazbritshme për qëllime tatimi	3	90
Humbjet sipas taksave që nuk janë regjistruar	-	-
Zhfrytëzimi i humbjeve sipas taksave të paregjistruara më parë	(60)	(13)
Ndryshimet tjera të përkohshme të paregjistruara	(79)	-
Shpenzimet e tatimit	17	88
Norma efektive e tatimit	1%	80%

Tatimi i shtyrë është kalkuluar në shkallën prej 10%. Aktivët nga të hyrat e shtyra tatimore janë njohur për humbjet tatimore vetëm deri në masën që realizimi i përfitimtatimor është i mundshëm. Me 31 Dhjetor 2014, aktivët nga të hyrat e shtyra tatimore, neto në shumën prej 270 mijë Euro nuk janë zbritur si diferencë neto e përkohshme për shkak të pasigurisë që një tatim i mjaftueshëm në fitim do të jetë në dispozicion për të lejuar shfrytëzimin e benefiteve nga ky aktiv tatimor i shtyrë.

	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej
Humbjet e bartura sipas taksave	(167)	(1,160)	(2,232)	67	789	(2,703)

Llogaritjet e tatimit të shtyrë

	31 Dhjetor 2013	Lëvizjet gjatë 2014	31 Dhjetor 2014
Efektet e tatimit nga diferencat e përkohshme të zbritshme			

Humbjet tatimore të bartura	(3,492)	789	(2,703)
Bruto Aktivët per tatime te shtyra (10%)	349	(79)	270
Minus: aktivët tatimore të shtyra të panjohura	(349)	79	(270)
Aktivët tatimore të shtyra, neto	-	-	-

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***9. Shpenzimet e tatim fitimit dhe tatimi I shtyrë (vazhdim)**

Sipas ligjit tatimor të Kosovës, humbjet tatimore mund të barten përpara dhe të kompensohen kundrejt të ardhurave deri në 7 periudha të një pasnjëshme tatimore.

Lëvizjet në të tatimin e shtyrë në fitim është si vijon:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrimi me 1 Janar	88	-
Shpenzimet	17	88
Detyrimi në fund të vitit	105	88

Detyrimi nga tatimi i shtyrë në fitim i takon zërave si vijon:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Provizionet për kreditë	105	88
	105	88

10. Paratë e gatshme dhe në banka

Paratë e gatshme dhe në banka përbëhen si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paratë e gatshme	5,421	5,502
Paratë e gatshme në bankë	2,460	2,445
Gjithsej	7,881	7,947

Paratë e gatshme në banka përbëhen nga llogaritë rrjedhëse dhe mund të përshkruhen si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Bankat vendore		
NLB Prishtina	(64)	1
Banka Kombëtare Tregtare	3	3
Banka Ekonomike	2	1
Raiffeisen Bank Kosovo	1	1
Bankat jo vendore		
Raiffeisen Bank International	168	393
Bank Austria Creditanstalt	953	1,035
Union Bank Tirana	20	11
Deutsche Bank AG	1,093	899
Komercijalna Banka	18	7
Banka Di Cividale S.P.A	82	13
NLB Slovenia	8	81
KBC	170	-
Uni Banca Italia	6	-
Gjithsej	2,460	2,445

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***11. Gjendja me me Bankën Qendrore të Kosovës**

Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës është si vijon:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Rezervat e obligueshme	7,979	7,758
Shumat e tjera në BQK	12,912	9,215
Gjithsej	20,891	16,973

Gjendja me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK") prej 20,891 mijë Euro më 31 dhjetor 2014 (31 dhjetor 2013: 16,973 mijë Euro) përfaqëson rezervën e mbajtur në BQK duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme që duhet të mbahet sipas rregullave të BQK-së. Gjatë vitit 2014 dhe 2013 Banka Qendrore e Kosovës nuk ka paguar ndonjë interes në rezervën minimale të likuiditetit.

12. Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Kreditë dhe paradhëniet për bankat përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Llogaritë e depozitave		
<i>Landes Bank</i>		
USD	659	906
<i>NLB Slovenia</i>		
EUR	-	100
<i>Union Bank Tirana</i>		
USD	-	73
Gjithsej depozitat	659	1,079
Llogaritë e bllokuara	1,211	1,067
Gjithsej	1,870	2,146

Depozita në Landes Bank në shumën prej 800 mije USD ka periudhë të kontraktuar maturimi 30 ditë dhe sjell interes 0.15% në vit.

Llogaritë e bllokuara në banka

Me 31 Dhjetor 2014 bilanci i llogarive të bllokuara përbëhet nga depozitat në Banca di Cividale të bllokuara për garancitë në vlerë prej 435 mijë Euro (31 Dhjetor 2013; 517 mijë Euro), depozitat në Raiffeisen Bank International të bllokuara për garancionet në vlerë prej 776 mijë Euro (31 Dhjetor 2013; 550 mijë Euro).

Me 31 Dhjetor 2014 Banka ka qene ne pajtim me te gjitha limitet te vendosura nga ana e BQK-se për ekspozimin maksimal lidhur me kapitalin e klasit të parë kundrejt një banke të vetme (2013: janë tejkalar limitet me Deutsche Bank AG dhe Raiffeisen Bank International AG).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***13. Investimet e mbajtura deri në maturitet**

Investimet e mbajtura deri në maturitet përfshijnë investimet që Banka i ka bërë në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Bilanci i investimeve të mbajtura deri në maturitet ishte si në vijim:

Gjendja me 31 Dhjetor 2014

Institucioni financiar	Monedha	Lloji	Maturimi	Norma e interes	Shuma e paguar	Interesi i perlogaritur	Gjithsej
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-08-2015	1.9%	294	2	296
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-08-2015	1.7%	295	2	297
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-08-2015	1.5%	295	2	297
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-08-2015	2.0%	98	1	99
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	23-01-2015	1.4%	199	1	200
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-05-2015	2.0%	495	1	496
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-05-2015	2.1%	495	1	496
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-05-2015	2.1%	495	1	496
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-05-2015	2.2%	495	1	496
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	19-05-2015	2.1%	99	1	100
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	09-12-2015	2.2%	98	-	98
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	11-02-2015	1.4%	99	1	100
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	22-04-2015	1.3%	99	1	100
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	17-06-2015	1.3%	99	1	100
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	21-10-2015	1.9%	490	1	491
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	21-10-2015	2.0%	490	2	492
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	21-10-2015	2.2%	98	1	99
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	14-01-2015	0.8%	100	-	100
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	18-03-2015	2.0%	495	2	497
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	18-03-2015	1.9%	495	3	498
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	18-03-2015	1.8%	495	3	498
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	18-03-2015	1.7%	495	2	497
Banka Qendrore e Kosovës	EUR	T. Bills	18-03-2015	1.8%	99	-	99
Ministria e ekonomisë dhe financave	EUR	G. Bonds	31-03-2016	2.4%	50	-	50
Ministria e ekonomisë dhe financave	EUR	G. Bonds	30-06-2016	2.6%	50	-	50
Ministria e ekonomisë dhe financave	EUR	G. Bonds	30-09-2016	2.9%	100	-	100
Ministria e ekonomisë dhe financave	EUR	G. Bonds	30-09-2016	2.9%	50	-	50
Ministria e ekonomisë dhe financave	EUR	G. Bonds	27-11-2016	2.9%	50	-	50
Gjithsej					7,212	30	7,242

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***13. Investimet e mbajtura deri në maturitet (vazhdim)****Gjendja me 31 Dhjetor 2013**

Institucioni financiar	Monedha	Lloji	Maturimi	Norma e interes	Shuma e paguar	Interesi i perlllogaritur	Gjithsej
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	23-04-2014	2.26%	78	1	79
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	22-01-2014	1.54%	4,168	29	4,197
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	19-02-2014	1.49%	2,134	12	2,146
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	19-03-2014	1.24%	3,528	5	3,533
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	15-01-2014	0.46%	5,584	13	5,597
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	21-05-2014	1.20%	98	-	98
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	12-02-2014	0.49%	250	-	250
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	21-05-2014	1.20%	99	1	100
Cental Bank of Kosovo	EUR	T. Bills	10-12-2014	1.72%	48	-	48
Gjithsej					15,987	61	16,048

14. Kreditë dhe paradhëniet për klientë

Kreditë dhe paradhëniet për klientë përbëhen si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	80,025	72,514
Provizionet për humbjet në kredi dhe paradhënie për klientët	(5,075)	(4,458)
	74,950	68,056
Interesi i përlllogaritur	549	551
Tarifat e shtyra të disbursimit	(520)	(491)
Kreditë dhe paradhëniet neto për klientë	74,979	68,116

Lëvizjet në provizionimin e humbjeve për kreditë dhe paradhëniet e klientëve janë si në vijim:

	2014	2013
Më 1 Janar	4,458	8,097
Provizioni për humbjet nga kreditë	2,059	1,593
Kreditë e shlyera	(1,442)	(5,232)
Më 31 Dhjetor	5,075	4,458

Me 31 Dhjetor, 2014 Banka ishte në përputhje me kërkesat e BQK-së sa i përket normës minimale prej 12% të kapitalit të përgjithshëm mbi mjetet e rrezikuara, dhe 8% për Kapitalin e klasit të Parë. Me 31 Dhjetor 2014 Banka nuk ishte në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me raportin e levës afariste (Gjithsej Ekuiteti / Gjithsej Aktivet). (31 Dhjetor 2013 nuk ishte në përputhje).

Banka ka tejkalluar kufijtë e vendosur nga BQK-ja për ekspozimin maksimal në lidhje me Kapitalin e klasit të I-rë për një klient apo grup të klientëve të ndërlidhur, dhe palëve të ndërlidhura në rastin e 1 ekspozimi me 31 Dhjetor 2014. BQK ka aprovuar kërkesën për zgjatjen e afatit për këtë rast deri më 30 Qershor 2015.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***15. Aktivet jo qarkulluese të mbajtura për shitje**

Aktivitet jo qarkulluese të mbajtura për shitje janë të përbëra nga pronat ku Banka ka marrë titullin e pronësisë për shlyerjen e borxheve të pashlyera ndaj Bankës. Me 31 Dhjetor, 2014 Banka ka pasur në posedim aktivet joqarkulluese të mbajtura për shitje si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Pasuritë e patundshme banesore	371	373
Pasuritë e patundshme komerciale	1,000	1,164
Gjithsej	1,371	1,537
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(528)	(307)
Vlera neto kontabël	843	1,230

Lëvizjet në provizione për zhvlerësimin e aktiveve jo qarkulluese të mbajtura për shitje janë si në vijim:

	2014	2013
Më 1 Janar	307	256
Provizioni për zhvlerësim gjatë vitit	241	51
Kthimet nga shitjet/heqjet	(20)	-
Më 31 Dhjetor	528	307

16. Aktive të tjera

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzimet e parapaguara	524	117
Aksionet e mbajtura për shitje nga banka (shënimi 22)	184	-
Kërkesat nga garancionet e paguara nga banka	113	123
Provizione për garancione të paguara nga banka	(113)	(123)
Gjithsej	708	117

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***17. Aktivet e patrupëzuara**

Lëvizjet në aktivet e patrupezuara janë si në vijim:

Kosto	Programe kompjuterike
Gjendja me 1 Janar 2013	829
Shtesat gjatë vitit	56
Bartje te aktivet e trupezuara	(70)
Heqjet gjatë vitit	(17)
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	798
Shtesat gjatë vitit	7
Bartje te aktivet e trupezuara	-
Heqjet gjatë vitit	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	805
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja me 1 Janar 2013	519
Shpenzimi për vitin	109
Bartje te aktivet e trupezuara	(70)
Heqjet gjatë vitit	(7)
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	551
Shpenzimi për vitin	109
Bartje te aktivet e trupezuara	-
Heqjet gjatë vitit	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	660
Shuma neto e bartur	
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	247
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	145

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***18. Pronat dhe pajisjet**

Lëvizjet në prona dhe pajisjet janë si në vijim:

	Ndërtesat	Përmirësimet në objektet e marra me qira	Mobilet, pjesët, dhe pajisjet	Pajisjet elektronike	Automjetet	Gjithsej
Kosto						
Gjendja më 1 Janar 2013	22	607	577	1,719	504	3,429
Shtesat gjatë vitit	-	94	49	102	19	264
Bartje nga aktivet e patrupezuara	-	-	-	70	-	70
Shitjet/heqjet gjatë vitit	-	(65)	(16)	(695)	(8)	(784)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	22	636	610	1,196	515	2,979
Shtesat gjatë vitit	96	29	9	108	16	258
Shitjet/heqjet gjatë vitit	-	(55)	(45)	(123)	(39)	(262)
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	118	610	574	1,181	492	2,975
Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja me 1 Janar 2013	22	538	445	1,309	231	2,545
Shpenzimi për vitin	-	45	58	120	78	301
Bartje nga aktivet e patrupezuara	-	-	-	70	-	70
Shitjet/heqjet gjatë vitit	-	(63)	(16)	(514)	(2)	(595)
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	22	520	487	985	307	2,321
Shpenzimi për vitin	-	42	52	97	76	267
Shitjet/heqjet gjatë vitit	-	(55)	(44)	(120)	(36)	(255)
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	22	507	495	962	347	2,333
Vlera kontabël						
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	-	116	123	211	208	658
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	96	103	79	219	145	642

Me 31 Dhjetor 2014 Banka nuk ka ndonjë pronë të deklaruar si peng.

Në kuader të pronave dhe pajisjeve me 31 Dhjetor 2014 është futur edhe ndertesa me vlerë 96 mijë euro (2013: zero) i cili është kolateral i riposeduar dhe menaxhmenti ka vendosur ta shfrytëzojë për aktivitetet e përditëshme të Bankes. Kjo prone është njohur në kosto minus zhvlerësimin e akumuluar me 31 Dhjetor 2014, me një kundërparti në kredi të rezervës së rivlerësimit në kapital sic shpjegohet në shënimin 22.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***19. Depozitat nga klientët**

Depozitat nga klientët janë të përbëra si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Llogaritë rrjedhëse	43,646	32,172
In EUR	41,955	29,377
Në monedha të huaja	1,691	2,795
Depozitat e afatizuara	59,357	68,645
In EUR	58,878	67,952
Në monedha të huaja	479	693
Gjithsej	103,003	100,817

Prej shumës totale 103,003 mijë Euro, shuma prej 1,150 mijë Euro përfaqëson interesin e përlllogarit me 31 Dhjetor, 2014 (31 Dhjetor, 2013: 1,730 mijë Euro).

20. Huamarrjet

Huamarrjet aktive përbëhen si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kredia e ndërvarur nga BERZH	1,000	1,000
Kredia e ndërvarur nga Valon Budima	400	400
Kredia e ndërvarur nga Armend Skeja	400	400
Gjithsej	1,800	1,800

Marrëveshjet për kreditë e ndërvarura 2013

Gjatë korrikut 2013 Banka nënshkroi marrëveshjen për kredinë e ndërlidhur me BERZH-in në shumë prej 1,000 mijë Euro. Kredia ka një normë të interesit prej 10% në vit që është i pagueshëm në baza kuartale, dhe borxhi kryesor është i ripagueshëm në një shumë të vetme me datë 31 korrik 2019.

Kjo kredi së bashku me dy kreditë tjera të ndërvarura të specifikuar më poshtë është shfrytëzuar me qëllim të rritjes së kapitalit të klasit të dytë dhe plotësimin e kërkesave rregullative të Bankës Qendrore të Kosovës.

Banka ka hyrë në marrëveshje me BERZH për kredinë e ndërvarur me disa kushte të indikatorëve financiar. Me 31 dhjetor 2014 banka nuk ishte në përputhje këta indikatorë:

- Kërkesat e BQK-së për ekspozimet mbi 15% të kapitalit për të cilën është marre aprovim nga BQK-ja për afat shtesë deri me 30 qershor 2015;
- Mbajtja e raportit të mjeteve likuide mbi depozita në 75% apo më shumë;
- Gjatë gjithë kohës, mbajtja e hendekut negativ të likuiditetit për secilin grup të maturitetit jo më shumë se 20%.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***20. Huamarrjet (vazhdim)**

Dy kreditë tjera të ndërlidhura prej personave fizik Valon Budima dhe Armend Skeja kanë një normë interesi prej 10% në vit, dhe të dyja janë të pagueshme në një pagesë të vetme me 26 Dhjetor 2023 dhe nuk kanë kushte të veqanta të lidhura me marrëveshjet për kreditë.

Zbatimi i të gjitha kërkesave që rrjedhin nga Ligji mbi Bankat dhe rregullat e Bankës Qendrore do të kërkojë që BPB-ja ti adresojë një numër aktivitetesh më me shumë rigorozitet, veçanërisht në fushat e kreditimit, riskut operacional, dhe të likuiditetit.

21. Detyrimet e tjera

Detyrimet tjera me 31 Dhjetor, 2014 dhe 2013 janë të përbëra si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Pagesat në emër të palëve të treta	212	390
Shpenzimet e përllogaritura të interesit	41	42
Provizionet për letër garancionet të lëshuara nga Banka	71	67
Të Pagueshme në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale	8	1,941
Të Pagueshme në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	83	77
Detyrime ndaj furnitorëve	120	110
Gjithsej	535	2,627

Pagesat në emër të palëve të treta

Pagesat në emër të palëve të treta kanë të bëjnë me pagesat ende të pa ekzekutuara për shkak të dallimit në mes të datës së valutës dhe datës së transaksionit. Ato ekzistojnë si llogari pezull nëpërmjet Sistemit Ndër-bankar të Kliringut (SNK).

Të pagueshme në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Banka vepron si agjent për transaksionet e kryera në emër të institucioneve qeveritare tek palët e treta (p.sh. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale).

22. Kapitali aksionar

Në Pajtim me Ligjin no. 04/L-093 për “Banka, Institucione Microfinanciare dhe Institucione Financiare Jo-Bankare”, kapitali aksionar minimal për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë 7 milion Euro. Lëvizja në numrin e aksioneve është si në vijim:

Aksione të zakonshme

<i>Numri i aksioneve</i>	2014	2013
Në emetim që nga 1 Janari	28,530	28,530
Shtesat	-	-
Në emetim që nga 31 Dhjetor	28,530	28,530

Më 31 Dhjetor 2014 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 28,530 aksione të zakonshme (2012: 28,530). Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 394.2 Euro secili (2013: 394.2 Euro). Të gjitha aksionet e emetuara janë paguar plotësisht. Pronarët e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividenda që deklarohen kohë pas kohe dhe kanë të drejtën e një vote për aksion në mbledhjet e Bankës. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me mjetet e mbetura të Bankës.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***22. Kapitali aksionar (vazhdim)**

Një përmbledhje e pronësisë së aksioneve të bankës është si vijon:

Emri i aksionarit	2014	2014	2013	2013
	%	EUR ('000)	%	EUR ('000)
Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
Rrustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
EBRD	10.00	1,125	10.00	1,125
Fikri Taipi	9.91	1,115	9.91	1,115
Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
Nazmi Viça	8.80	989	8.80	989
Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
Getoari sh.p.k	-	-	1.63	184
BPB	1.63	184	-	-
Gazi Trade	-	-	1.61	181
Rasim Gashi	1.54	173	1.54	173
Riza Mikullovc	1.45	163	1.45	163
Others	1.26	141	1.26	141
DMTH shpk	3.27	367	1.01	113
Medisan Commerce	-	-	0.65	73
Naser Aliu	0.62	70	0.62	70
Besnik Vrella	0.62	70	0.62	70
Agim Bilalli	0.62	70	0.62	70
Flamur Bryma	0.53	60	0.53	60
Gjithsej	100	11,247	100	11,247

Rezerva tjetër e kapitalit

Rezerve tjetër e capital u krijuar me 31 Dhjetor 2011 si rezultat I diferences së humbjes së akumuluar në përputhje me SNRF dhe BQK, te cilat ishin shlyer permes pakësimit në kapitalin aksionar. Si pasojë, keto rezerva janë të kufizuara dhe nuk mund të shpërndahen.

Rezerva e rivleresimit reserve

Gjatë vitit 2014, Banka vendosi të përfshijë te Pronat dhe Pajisje sic përmenden në shënimin 18, një ndërtesë që fillimisht është zotëruar si kolateral i riposeduar. Ndërtesa u njoh nga Banka te Prona dhe Pajisje me një shumë korresponduese si rezervë rivlerësimi në kapital.

Banka në të kaluaren ka lëshuar kredi te një ish aksionar i saj ("Getoari") në shumë prej 1,800 mijë euro. Kredia ishte e siguruar me aksionet e hipotekuara në bankë në shumën prej 183 mije euro. Aksionari ka deshtuar ta ripaguajë kredine.

Kredia ishte provizionuar 100% gjatë vitit 2013 në shumë prej 1,800 mijë euro. Gjatë vitit 2013 provizionit u kthye për aksionet e hipotekuara si kolateral në shumë prej 183 mijë euro.

Gjatë vitit 2014 pas vendimit të gjyqit për riposedimin e aksioneve të hipotekuara, menaxhmenti i bankës ka vazhduar ti njoh këto aksione si pjese e kapitalit të paguar dhe gjithashtu janë trajtuar si aksione të mbajtura për shitje në kategorinë përkatëse të mjeteve të shpalosura në notën 16 të aktiveve tjera.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***23. Paratë dhe ekuivalentet e parasë**

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme përbëhen si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Paratë e gatshme dhe në banka (referojuni shënimit 10)	7,881	7,947
Gjendja me BQK – të pakufizuara (referojuni shënimit 11)	12,912	9,215
Kreditë dhe paradhëniet e institucioneve financiare me maturitet prej tre muajve ose më pak	1,089	1,749
Gjithsej	21,882	18,911

24. Aktivitetet e ne emër të palëve të treta

Banka kryen shërbime në emër të palëve të treta të cilat janë kryesisht në formë të pagesave të klientëve të institucionet e ndryshme. Banka merr të hyra nga tarifat për ofrimin e këtyre shërbimeve. Aktivitetet e trustit nuk janë aktive të Bankës dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

25. Zotimet dhe kontigjentët

Zotimet dhe kontigjentët përfshijnë garancionet e dhëna klientëve. Gjendja përbëhet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Të siguruar me depozita në para të gatshme	759	1,558
Të siguruar me peng	2,881	6,556
Gjithsej	3,640	8,114

Ligjore

Banka përfshihet në procedura të zakonshme ligjore në rrjedhën normale të biznesit. Mendimi i menaxhmentit është se rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do të ketë një efekt material në rezultatet e Bankës.

Zotimet e qirasë

Zotimet e qirasë lidhen me shpenzime minimale të qirasë së paguar për zyrat me qira të Bankës. Qiratë operative të pa anulueshme janë të pagueshme si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Jo më vonë se 1 vit	337	388
Gjithsej	337	388

Detyrimet për tatime

Për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, librat dhe regjistrat tatimore të Bankës nuk janë inspektuar nga autoritetet lokale të tatimeve. Banka i ka ndjekur të gjitha rregullat dhe rregulloret gjatë llogaritjes së detyrimeve për tatime, megjithatë interpretimet e tatimit nga ana e autoritetit të tatimeve mund të ndryshojnë nga ato që janë përdorur nga Banka.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar****(a) Hyrje dhe përmbledhje**

Banka është e ekspozuar në rreziqet e mëposhtme nga përdorimi i mjeteve financiare:

- risku i tregut
- risku i kreditimit
- risku i likuiditetit

Ky dokument prezanton informata për ekspozimin e bankës ndaj secilit nga rreziqet e përmendura më lartë, objektivin e bankës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të bankës.

Korniza për menaxhimin e riskut

Bordi i drejtorëve (“Bordi”) ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kornizës së Bankës për menaxhimin e riskut. Bordi ka themeluar Këshillin e Mjeteve dhe Detyrimeve (“ALCO”), Këshillin e Kredive, Këshillin e Auditimit, dhe Këshillin e Riskut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të bankës mbi menaxhimin e riskut në fushat e tyre specifike. Të gjitha këshillet e bordit kanë anëtar ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e bankës për menaxhimin e riskut janë themeluar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Banka, për të vendosur kufizimet e duhura të riskut dhe kontrollit si dhe të monitorojnë riskun dhe respektojnë limitet. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka, përmes trajnimeve, procedurave dhe politikave për menaxhim, synon të zhvillojë një ambient kontrollues konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Këshilli i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e riskut të Bankës dhe për të vlerësuar adekuatshmërinë e kornizës për menaxhimin e riskut në raport me rreziqet me të cilat përballlet Banka. Këshilli i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti për Auditimin e Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikimet e rregullta dhe Ad-hoc të kontrollit dhe procedurave për menaxhim të riskut, rezultati i të cilave raportohet tek Këshilli i Auditimit.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (v azhdimi)****(b) Risku i tregut**

Risku i tregut është risku në ndryshimin e çmimeve të tregut, sikurse normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e huaja të këmbimit valutor dhe spredi kreditor (pa u ndërlidhur me ndryshimet e qëndrimit debitorit/dhënësit të kredisë) do të ndikojë në të hyrat e bankës apo vlerën e posedimit të instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të riskut të tregut është të administroj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj riskut financiar brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që përmirëson kthimin në risk.

Menaxhimi i riskut te tregut**Ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit**

Operacionet e bankës i nënshtrohen riskut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që sjellin interes dhe detyrimet që sjellin interes të maturohen apo të ri-vlerësohen në kohë të ndryshme apo në shuma të ndryshme. Në rastin e normave të luhatshme të aktiveve dhe detyrimeve, Banka gjithashtu i ekspozohet riskut themelor, që është dallimi i karakteristikave të ri-vlerësimit të disa indekseve të normave të luhatshme të interesit siç janë normat e llogarive të kursimeve, LIBOR-i dhe lloje të ndryshme të interesave. Aktivitetet për menaxhimin e riskut synojnë të përmirësojnë të ardhurat neto të interesave, duke marrë parasysh nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të bankës.

Aktivitetet për menaxhimin e riskut të aktiveve-pasives kryhen në kontekst të ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve të normave të interesit. Në mjediset e zvogëlimit të normave të interesave, margjinat e fituara do të ngushtohen pasi që interesat e pasives do të zvogëlohen me një përqindje më të vogël në krahasim me normat e interesave të aktiveve. Megjithatë, efekti i vërtet varet në disa faktor të ndryshëm, përfshirë stabilitetin e ekonomisë, mjedisin dhe nivelin e inflacionit.

Menaxhimi i riskut të normave të interesit kundër limiteve të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të bankës ndaj skenarëve të ndryshëm të normave standarde dhe jostandarde të interesit. Skenarët standard përfshijnë një rënie apo ngritje paralele prej 1% në të gjitha lakoret e interesit.

Normat efektive mesatare te kategorive me te rëndesishme te aktiveve dhe detyrimeve financiare te Bankes me 31 dhejtor 2014 dhe 2013 jane si vijon:

Aktivet	USD		EUR	
	2014	2013	2014	2013
Paraja dhe gjendja me Bankën Qendrore	0.0%	0.15%	0.00%	0.62%
Kredite e klienteve	-	-	11.48%	11.20%
Letrat me vlerë deri në maturitet	-	-	1.90%	1.17%
Detyrimet				
Depozitat e klientëve	0.66%	2.32%	2.08%	2.48%
Huazimet	-	-	10.04%	10.04%

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(b) Risku i tregut****Ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit (vazhdim)**

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregutn e normave të interesit (duke supozuar jo një lëvizje asimetrike në lakoren e përqindjeve dhe një pozitë financiare stabil) është si vijon:

2014	Skenari deri në një vit		Skenari mbi një vit	
	100 bp Rritje	100 bp Pakësim	100 bp Rritje	100 bp Pakësim
Ndikimi ne fitim (humbje)	106	(106)	180	(180)
2013	Skenari deri në një vit		Skenari mbi një vit	
	100 bp Rritje	100 bp Pakësim	100 bp Rritje	100 bp Pakësim
Ndikimi ne fitim (humbje)	26	(26)	87	(87)

Ekspozimi ndaj riskut valutor

Banka i ekspozohet riskut valutor përmes transaksioneve në valuta të huaja. Banka siguron që ekspozimi neto mbahet në një nivel të pranueshëm duke blerë apo shitur valuta të huaja aty për aty kur është e nevojshme për të zgjidhur bilancet afat-shkurtra.

Një analizë e ndjeshmërisë së bankës ndaj një rritje apo zbritje në kursin e valutave të huaja është si vijon:

Në mijë EUR	Dollar Amerikan (USD)		Franga të Zvicrës (CHF)		Funta e Britanisë së Madhe (GBP)	
	2014	2013	2014	2013	2014	2013
Shkalla e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitimi apo humbja						
+5% të Euro-s	0.45	(4.15)	4.25	7.4	1.05	4.15
- 5% të Euro-s	(0.45)	4.15	(4.25)	(7.4)	(1.05)	(4.15)

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdimi)****(b) Risku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj riskut valutor (vazhdim)**

Ekspozimi i bankës ndaj riskut të jashtëm valutor është si vijon:

Të gjitha shumat janë konvertuar në mije Euro

31 Dhjetor 2014	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Aktivët financiarë					
Paratë e gatshme dhe në banka	5,377	514	1,839	151	7,881
Gjendja me BQK-në	20,891	-	-	-	20,891
Investime të mbajtura deri në maturim	7,242	-	-	-	7,242
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	1,086	659	125	-	1,870
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	74,979	-	-	-	74,979
Gjithsej aktivët financiarë	109,575	1,173	1,964	151	112,863
Detyrimet financiare					
Depozitat e klientëve	99,830	1,164	1,879	130	103,003
Huamarrjet	1,800	-	-	-	1,800
Detyrimet e tjera	535	-	-	-	535
Gjithsej detyrimet financiare	102,165	1,164	1,879	130	105,338
Pozita e monedhave të huaja, neto	7,410	9	85	21	7,525

31 Dhjetor 2013	EUR	USD	CHF	GBP	Total
Aktivët financiarë					
Paratë e gatshme dhe në Bankë	5,286	513	2,049	99	7,947
Gjendja me BQK-në	16,973	-	-	-	16,973
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	1,168	977	-	1	2,146
Kreditë dhe paradhëniet për konsumatorët	68,116	-	-	-	68,116
Investime të mbajtura deri në maturim	16,048	-	-	-	16,048
Gjithsej aktivët financiarë	107,591	1,490	2,049	100	111,230
Detyrimet financiare					
Depozitat e klientëve	97,326	1,573	1,901	17	100,817
Huaja	1,800	-	-	-	1,800
Detyrimet e tjera	2,560	-	-	-	2,560
Gjithsej detyrimet financiare	101,686	1,573	1,901	17	105,177
Pozita e monedhave të huaja, neto	5,905	(83)	148	83	6,053

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(c) Risku kreditor**

Risku kreditor është risku i humbjeve financiare për Bankën nëse një klient apo një palë tjetër e lidhur për një instrument financiar dështon të përmbush detyrimet kontraktuale, që vijnë nga kreditë dhe paradhëniet e Bankës për klientët dhe për bankat e tjera. Me qëllim të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka merr parasysh dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (të tilla si risku standard i huamarrësit individual, risku shtetëror dhe sektorial).

Menaxhimi i riskut kreditor

Bordi i Drejtorëve e ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e riskut kreditor Komitetit të Riskut që aprovon të gjitha ekspozimet kreditore për këto kategori: kredi biznesi SME, dhe kredi personale PI deri në 50 mijë euro (2013: deri 20 mijë euro) të cilat duhet të aprovohen nga Divizioni i Riskut / Komiteti i Kredive, përveç kredive PI deri në 10 mijë euro të cilat aprovohen nga dega.

Ekspozimet kreditore më të mëdha se 50 mijë euro (2013: 20 mijë euro) dhe më pak se 10% e kapitalit të Bankës aprovohen nga nga Divizioni i Riskut / Komiteti i Kredive derisa ekspozimet mbi 10% të kapitalit të bankës duhet të aprovohen nga Bordi i Drejtorëve.

Njësi të ndara të divizioneve të Riskut dhe Shitjes janë përgjegjës për mbikëqyrjen e riskut të kredive bankare, duke përfshirë:

- Përpilimi i politikave kreditore, mbulimi i kërkesave për peng, vlerësimin e kredive, kategorizimin dhe raportimin e riskut, procedurat administrative dhe ligjore, dhe përputhja me kërkesat rregullative dhe statutoe.
- Rishikimi dhe vlerësimi i riskut kreditor. Departamenti i kredive vlerëson të gjitha ekspozimet kreditore që tejkalojnë limitet e përcaktuara para lehtësimeve që u zotohen klientëve.
- Kufizimi i koncentrimin të ekspozimit ndaj zonave gjeografike dhe industrisë
- Vendosja e shkallëve të riskut kreditor të Bankës në mënyrë që të kategorizohen ekspozimet sipas shkallës së riskut të humbjes financiare me të cilat ballafaqohen dhe menaxhmenti të fokusohet në risk. Sistemi për vlerësimin e riskut përdoret për përcaktimin ku mund të kërkohet provizionimi i humbjeve. Komiza aktuale për vlerësimin e riskut përbëhet nga 5 shkallë që pasqyrojnë shkallë të ndryshme të riskut të mos pagimit dhe disponueshmërisë së pengut.
- Rishikimi i pajtueshmërisë me limitet e miratuara të ekspozimit, duke përfshirë ato për industrinë, rreziqet e vendit dhe llojet e produkteve.
- Raportet e rregullta për ekspozimin e kredive, kategorizimin e riskut dhe provizionimin e humbjeve paraqiten tek Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor dhe ndërmerren veprimet e duhura korrigjuese.
- Njësi brenda divizionit kreditor u kërkohet të zbatojnë politika dhe procedurat kreditore, dhe janë përgjegjës për kualitetin dhe performancën e portofolios së tyre si dhe për monitorimin dhe kontrollimin e të gjitha rreziqeve kreditore në portofolion e tyre.
- Auditimet e rregullta të proceseve të departamentit kreditor ndërmerren nga Divizioni i Auditimit të Brendshëm.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(c) Risku kreditor (vazhdim)**

Ekspozimi ndaj riskut të kredive më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013.

	Kreditë dhe paradhëniet për konsumatorët		Investimet e mbajtura deri ne maturitet		Kreditë dhe paradhëniet për bankat		Garancionet financiare	
	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013
<i>Provizionimet individuale</i>			-	-				
Shuma bruto	44,230	41,976	-	-	-	-	-	-
Provizione për humbje	(4,006)	(3,175)	-	-	-	-	-	-
Vlera kontabël	40,224	38,801	-	-	-	-	-	-
<i>Provizionimet e përgjithshme</i>			-	-	-	-	-	-
Shuma bruto	35,825	30,598	7,242	16,048	1,870	2,146	3,640	8,114
Provizione për humbje	(1,070)	(1,283)	-	-	-	-	(84)	(190)
Vlera kontabël	34,755	29,315	7,242	16,048	1,870	2,146	3,556	7,924
Gjithsej	74,979	68,116	7,242	16,048	1,870	2,146	3,556	7,924

Kreditë e provizionuara

Kreditë e provizionuara janë kredi për të cilat Banka konstaton se është e mundur që nuk do të mund të mbledh borxhin kryesor dhe interesin sipas kushteve kontraktuale të kredisë. Këto kredi kategorizohen nga A-ja tek E-ja në sistemin e brendshëm të vlerësimit të kredive, ku A është Standarde, kurse E është Humbje. Politika e dhënies së këtyre kredive është detajuar në shpalosjen 3f (vii).

Vlerësimi individual dhe kolektiv i portofolios së kredive

Për qëllime të menaxhimit të brendshëm, Banka ndanë kreditë në kredi që janë vlerësuar individualisht për provizionim; këto janë kredi janë klasifikuar si nën-standarde apo më të ulëta. Të gjitha kreditë e tjera menaxhohen kolektivisht për qëllime të brendshme të provizionimit.

Me ditë në vonesë por të paprovizionuara

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku pagesat e borxhit kryesor apo interesit të kontraktuar janë në vonesë, por që Banka beson se provizionimi nuk nevojitet në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm, dhe nivelit aktual të mbledhjes së borxhit të bankës.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(c) Risku kreditor (vazhdim)****Kreditë me kushte të ri-negociuara**

Kreditë me kushte të ri-negociuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit ku Banka ka bërë koncesione të cilat në rrethana tjera nuk do ti merrte në konsideratë. Pasi të ristrukturohet kredia mbetet në këtë kategori pavarësisht nga ecuria e kënaqshmërisë pas ri-strukturimit.

Provizionet për humbje

Banka vendos provizione për humbjet nga zhvlerësimet e shkaktuara në portofolion e kredive. Gjendja e provizioneve është një komponentë specifike e humbjes që ndërlidhet me ekspozimet e rëndësishme individuale.

Politika e fshirjes

Banka fshinë një kredi (dhe çfarëdo provizion për humbje) kur Bordi i Drejtorëve përcakton se kreditë janë të pa-arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pas shqyrtimit të informatave siç janë shfaqja e ndryshimeve të rëndësishme në huamarrësin ashtu që huamarrësi nuk mundet më të paguaj detyrimin apo që të ardhurat nga pengu nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar gjithë vlerën e ekspozimit.

Më poshtë është një analizë e shumave neto dhe bruto (të provizionimeve për humbje) të mjeteve sipas shkallës së rrezikut duke përjashtuar interesin aktual dhe tarifën e shtyra të disbursimit.

Kreditë të klientët	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
As në vonesë as të provizionuara	61,174	54,508
Në vonesë dhe të testuara individualisht por të paprovizionuara	8,290	10,360
Të paprovizionuara	10,590	7,706
Gjithsej	80,054	72,574
Provizionet	(5,075)	(4,458)
Gjithsej kreditë, neto nga provizionet	74,979	68,116

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(c) Risku kreditor (vazhdim)**

Banka mban pengun për kreditë dhe paradhëniet për klientët në formë të interesit hipotekar mbi pronën dhe mjetet e tjera të luajtshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë janë të bazuara në vlerën e llogaritur të pengut në kohën e marrjes së kredisë. Përgjithësisht pengu nuk mbahet për hua dhe paradhënie për banka.

Një përlogaritje e vlerës së tregut të kolateralit dhe mjeteve tjera të sigurisë të mbajtura kundrejt mjeteve financiare tregohet më poshtë:

	Kreditë dhe paradhëniet për klientët	
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Prona	124,569	97,430
Pajisje	85,462	51,340
Të mira materiale	18,864	22,358
Gjithsej	228,895	171,128

Banka monitoron koncentrimet e rreziqeve kreditore në bazë të sektorëve dhe vendndodhjes gjeografike. Një analizë e koncentrimëve të rreziqeve kreditore në datën e raportimit tregohet më poshtë:

	Kreditë dhe paradhëniet për klientët		Investimet e mbajtura deri në maturitet		Huatë dhe paradhëniet për bankat		Garancionet financiare	
	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013
Përqendrimet sipas sektorëve								
Korporata	53,537	49,399	-	-	-	-	3,556	7,924
Banka	-	-	7,242	16,048	1,870	2,146	-	-
Shitja	21,442	18,717	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	74,979	68,116	7,242	16,048	1,870	2,146	3,556	7,924
Përqendrimet sipas lokacionit								
Vendet e BE-së	-	-	-	-	1,870	2,073	1,012	1,529
Republika e Kosovës	74,979	68,116	7,242	16,048	-	-	2,544	6,395
Vende të tjera	-	-	-	-	-	73	-	-
Gjithsej	74,979	68,116	7,242	16,048	1,870	2,146	3,556	7,924

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(d) Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Banka do të ballafaqohet me vështirësi në përbushjen e detyrimit të saja financiare.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të siguroj, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përbushur detyrimet me kohë, sipas kushteve normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtoj reputacionin e Bankës.

Këshilli për Menaxhimin e Riskut të Likuiditetit (KMRL) merr informata nga divizioni i pagesave me jashtë dhe nga departmente tjera në lidhje me profilin e likuiditetit të mjeteve dhe detyrimeve të tyre financiare dhe detaje të flukseve të tjera të projektuara të parave të gatshme që vijnë nga planifikimi i biznesit në të ardhmen. Atëherë KMRL në bashkëpunim me pagesat e jashtme krijon portofolion e mjeteve afat-shkurtra likuide, të përbëra kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet afat-shkurtra për bankat, për të siguruar mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të likuiditetit brenda bankës.

Pozicioni ditor i likuiditetit dhe kushtet e tregut monitorohen në mënyrë të rregullt. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga ALCO. Raportet ditore mbulojnë pozicionin e likuiditetit të Bankës. Raportet e likuiditetit i dorëzohen çdo muaj BQK-së.

Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit

Banka ka qasje në një bazë të shumëllojshme të financimit. Fondet mblihen duke përdorur një gamë të gjerë të mjeteve duke përfshirë depozitat, huamarrjet dhe kapitalin aksionar.

Fleksibiliteti e kufizon varësinë nga cilido burim i fondeve dhe në përgjithësi e ul koston e fondeve. Banka përpiket të mbaj bilancin në mes të vazhdimësisë së financimit dhe fleksibilitetit përmes shfrytëzimit të detyrimeve me afate të ndryshme të maturitetit. Banka vazhdimisht vlerëson riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet e nevojshme në financim për të përbushur qëllimet e biznesit të vendosura në kushtet e strategjisë së përgjithshme të Bankës. Përveç kësaj Banka mban një portofolio të mjeteve likuide si pjesë e strategjisë së saj për administrimin e riskut të likuiditetit.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(d) Risku i likuiditetit****Menaxhimi i riskut të likuiditetit**

Vlerat e mbetura kontraktuale të mjeteve dhe detyrimeve financiare:

31 Dhjetor 2014	Deri në 1 Muaj	1 deri 3 Muaj	3 deri 6 Muaj	6 deri 12 Muaj	Mbi 12 Muaj	Gjithsej
Aktivët financiarë						
Paratë e gatshme dhe në banka	7,881	-	-	-	-	7,881
Gjendja me BQK-në	20,891	-	-	-	-	20,891
Kreditë dhe paradhëniet për banka	999	90	290	491	-	1,870
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	3,553	9,122	8,313	16,920	37,071	74,979
Investimet e mbajtura deri në maturitet	200	2,191	2,282	2,170	399	7,242
Gjithsej	33,524	11,403	10,885	19,581	37,470	112,863

Detyrimet financiare

Depozitat e klientëve	56,425	2,103	4,546	22,394	17,535	103,003
Huamarrjet	-	-	-	-	1,800	1,800
Detyrimet e tjera	535	-	-	-	-	535
Gjithsej	56,960	2,103	4,546	22,394	19,335	105,338
Diferenca e likuiditetit	(23,436)	9,300	6,339	(2,813)	18,135	7,525

31 Dhjetor 2013

	Deri në 1 Muaj	1 deri 3 Muaj	3 deri 6 Muaj	6 deri 12 Muaj	Mbi 12 Muaj	Gjithsej
Mjetet financiarë						
Paratë e gatshme dhe në banka	7,947	-	-	-	-	7,947
Gjendja me BQK-në	16,973	-	-	-	-	16,973
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	458	486	25	1,146	31	2,146
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	4,680	8,406	8,227	14,011	32,792	68,116
Investimet e mbajtura deri në maturitet	9,792	5,929	179	148	-	16,048
Gjithsej	39,850	14,821	8,431	15,305	32,823	111,230

Detyrimet financiare

Depozitat e klientëve	41,401	3,989	8,308	24,748	22,371	100,817
Huamarrjet	-	-	-	-	1,800	1,800
Detyrimet e tjera	2,560	-	-	-	-	2,560
Gjithsej	43,961	3,989	8,308	24,748	24,171	105,177
Diferenca e likuiditetit	(4,111)	10,832	123	(9,443)	8,652	6,053

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(d) Risku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela e mëparshme tregon rrjedhjet e paskontuara të detyrimeve financiare të Bankës dhe zotimet e panjohura të kredive në bazë të vlerave të mëhershme kontraktuale. Flukset e pritura të rrjedhës së parasë në Bankë varen fuqishëm nga kjo analizë. Për shembull, kërkesat për depozita nga klientët priten të kenë një balancë stabile apo të rritur.

Banka vepron në kushte të zhvillimit global dinamik financiar dhe të krizës ekonomike. Rritja e mëtejme mund të rezultojë me implikime negative në pozitën financiare të Bankës. Menaxhmenti i Bankës kryen monitorimet ditore mbi të gjitha pozitat e mjeteve dhe detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve si dhe zhvillimin e tregjeve ndërkombëtare financiare, duke aplikuar praktikat më të mira bankare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon rentabilitetin, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe zbaton masat adekuate sa i përket kredive, tregut (kryesisht normës së interesit) dhe riskun e likuiditetit dhe përmes kësaj kufizon efektet e mundshme negative nga krizat globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë banka i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut, duke mbajtur një pozitë stabile të kapitalit dhe likuiditetit.

(e) Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e instrumenteve financiare do të luhatet për shkak të ndryshimeve në tregun e normës së interesit dhe nga risku që vlera e mjeteve me interes do të ndryshoj nga vlera e detyrimeve me interes të përdorura për të financuar këto mjete. Kohëzgjatja për të cilën shkalla e interesit në një mjet financiar është e fiksuar tregon se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Mjetet dhe kushtet e depozitave të klientëve të bankës bartin norma fikse të interesit. Normat e interesit të zbatueshme për mjetet dhe detyrimet financiare janë të shpalosura në shpalosjen përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

Operacionet bankare janë subjekt i riskut të luhatjes së normave të interesit deri në masën që mjetet dhe detyrimet me interes maturojnë apo ndryshojnë çmimet në kohëra të ndryshme apo në shuma të ndryshme. Banka tenton të zbus këtë risk duke i monitoruar datat e ndryshimit të çmimeve të mjeteve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual varet nga një numër i faktorëve të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë më herët apo më vonë se datat e e kontraktuara dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhës së ndryshimit të çmimeve dhe ndërmjet valutave të ndryshme.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(e) Risku i normës së interesit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme tregon instrumentet financiare që bartin interes dhe ato që nuk bartin interes

	31 Dhjetor 2014			31 Dhjetor 2013		
	Që bartin interes	Që nuk bartin interes	Gjithsej	Që nuk bartin interes	Që nuk bartin interes	Gjithsej
Aktivët financiarë						
Parat e gatshme dhe në Bankë	-	7,881	7,881	-	7,947	7,947
Gjendja me BQK-në	-	20,891	20,891	-	16,973	16,973
Kreditë dhe paradhënit për bankat	1,870	-	1,870	2,146	-	2,146
Investimet e mbajtura deri në maturim	7,242	-	7,242	16,048	-	16,048
Kreditë për klientët	74,979	-	74,979	68,116	-	68,116
Gjithsej aktivët financiarë	84,091	28,772	112,863	86,310	24,920	111,230
Detyrimet financiare						
Depozitat e klientëve	59,357	43,646	103,003	68,645	32,172	100,817
Detyrimet e tjera	-	535	535	-	2,560	2,560
Huamarjet	1,800	-	1,800	1,800	-	1,800
Gjithsej detyrimet financiare	61,157	44,181	105,338	70,445	34,732	105,177
Risku i interesit, neto	22,934	(15,409)	7,525	15,865	(9,812)	6,053

(f) Menaxhimi i riskut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vetë për të siguruar që Banka do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas principit të vazhdueshmërisë përderisa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes përmirësimit të borxhit dhe bilancit të kapitalit. Strategjia e përgjithshme e bankës mbetet e pandryshuar nga viti 2013.

Struktura e kapitalit të bankës përbëhet nga kapitali i lëshuar, rezerva për riskun e përgjithshëm dhe fitimet e mbajtura.

Kapitali rregullativ

Banka monitoron adekuatshërinë e kapitalit, me theks të veçantë rregullat dhe indikatorët e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"). "Indikator i Adekuatshërisë së Kapitalit" është raporti i kapitalit rregullativ me mjetet e peshuara me rrezik, pjesitë jashtëbilancore dhe rreziqet tjera i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar për Indikatorin e Adekuatshërisë së Kapitalit është 8% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për gjithsej Kapitalin.

Aktivët e peshuara me rrezik (MPRR)

Aktivët peshohen sipas kategorive të gjëra të rrezikut kombëtar, duke ia mveshur peshën e rrezikut sipas shumës së kapitalit që do të nevojitet për ti mbështetur ato.

Gjashtë kategori të peshimit të rrezikut (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, 150%) aplikohen; Për shembull instrumentet e keshit dhe tregut të parave peshohen me zero rrezik, që nënkupton që nuk nevojitet kapital shtesë për ti mbajtur këto aktive. Pasuria dhe pajisjet peshohen me 100% rrezik duke nënkuptuar se duhet pajtë të mbështeten me Kapital (Klasit të parë) baraz me 8% të vlerës kontabël. Zotimet kreditore të zërave jashtëbilancor janë marrë në konsideratë. Shumat pastaj janë peshuar me rrezik me përqindjen e njëjtë sikurse për aktivët bilancore.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***26. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****(f) Menaxhimi i riskut të kapitalit (vazhdim)**

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Gjithsej aktivet e peshuara me rrezik	71,138	63,112
Gjithsej ekspozimet jashtëbilancore të peshuara me rrezik	2,531	4,447
Gjithsej aktivet e peshuara me rrezik për rrezikun operacional	9,600	9,259
Gjithsej	83,269	76,818
Kapitali rregullativ (Gjithsej Kapitali)	11,148	9,937
Indikator i Adekuatshmerisë së Kapitalit (Gjithsej Kapitali)	13.39%	12.94%

Politikë e bankës është që të mbajë bazë të fortë të kapitalit në mënyrë që të ofrojë besim të plotë tek investitorët, kreditorët dhe tregu dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm të biznesit në të ardhmen.

Ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin të aksionarët poashtu është njohur dhe banka njihet nevojën për të mbajtur një bilanc ndërmjet kthimeve të larta të cilat do të mundësoheshin me fitime më të mëdha, dhe prioriteteve dhe sigurisë së arritur nga pozita e fortë e kapitalit (referoju shpalosjes 14 kreditë dhe paradržëniet të klientët për më shumë detaje rreth adekuatshmerisë së kapitalit dhe kërkesave tjera të BQK-së).

Nuk ka pasur ndryshime materiale në menaxhimin e kapitalit të bankës gjatë kësaj periudhe.

Koeficienti i borgjit

Këshilli i Bankës për menaxhimin e riskut rishikon strukturën e kapitalit në mënyrë të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, Këshilli merr në konsideratë koston e kapitalit dhe riskun që ndërlidhet me secilën klasë të kapitalit.

27. Transaksionet me palët e ndërlidhura

Një palë është e ndërlidhur me një njësi ekonomike, drejtpërdrejt apo indirekt përmes një apo më shumë ndërmjetësve, kur pala kontrollon, kontrollohet, apo është nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, kur pala ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj ndikim të rëndësishëm mbi këtë njësi, pala ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike, pala është një partner apo është anëtar i personelit kyç të administrimit të njësisë ekonomike apo njësisë amë.

Një përshkrim i transaksioneve me palët e ndërlidhura në fund të vitit duket si në vijim:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Aktivët:		
<i>Kreditë aktive në fund të vitit me aksionarët dhe menaxhmentin e lartë</i>		
Newco Jugo Term	1,488	2,058
ENG Office	470	470
Getoari	-	184
Aksionarët dhe menaxhmenti tjetër	262	821
Gjithsej	2,220	3,533
Garancionet dhe letër kreditet me aksionarët	-	67
Kreditë dhe paradržëniet të Banka Di Cividale	435	517

Banka për Biznes Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare**

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

*(Shumat janë në mijë EUR, përveç nëse janë deklaruar ndryshe)***27. Transaksionet me palët e ndërlidhura (vazhdim)**

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrimet:		
Llogaritë e klientëve me aksionar		
Newco Jugo Term	1,528	1,570
Nazmi Viça	-	392
ENG Office	470	470
Aksionarët dhe menaxhmenti tjetër	115	548
Gjithsej	2,113	2,980
Huazimi nga BERZH	1,000	1,000
Më poshtë janë transaksionet me palët e ndërlidhura gjatë vitit.		
	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2014	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2013
Të ardhurat:		
Të ardhura nga interesi	203	258
Të ardhura nga tarifa dhe provizioni	4	15
Gjithsej të hyrat	207	273
Shpenzimet:		
Shpenzimet e interesit nga huazimet prej BERZH	103	200
Kompensimi i menaxhmentit kryesor	290	218
Kompensimi i bordit të drejtorëve	23	24
Gjithsej shpenzimet	416	442

28. Ngjarjet pasuese

Pas datës së bilancit të gjendjes nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme që mund do të kërkonte rregullime apo shpalesje në pasyrat financiare.



www.bpbbank.com